INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA SH.A.

Pasqyrat Financiare

për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020

(me raportin e audituesve të pavarur)

Përmbajtja

RAPORTI I AUDITUESVE TË PAVARUR 0
Pasqyra e Pozicionit Financiar 1
Pasqyra e fitim humbjeve dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse 2
Pasqyra financiare e ndryshimeve në kapital 3
Pasqyra financiare e ndryshimeve në kapital 4
Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare 5
1. Subjekti raportues 6
2. Bazat e Përgatitjes 6
3. Bazat e matjes 6
4. Monedha funksionale dhe raportuese 6
5. Përmbledhje e çmuarjeve dhe gjykimeve kontabël 6
6. Përmbledhje e politikave kontabël 7
7. Administrimi i Riskut Financiar 23
7. Administrimi i Riskut Financiar (vazhdim) 24
8. Aktivet dhe Detyrimet Financiare 56
9. Mjete monetare dhe të ngjashme 58
10. Hua dhe paradhënie bankave 58
11. Letra me vlerë të investimit 59
12. Hua dhe paradhënie klientëve 60
13. Aktive afatgjata të mbajtura për shitje 60
14. Ndërtesa dhe Pajisje 61
15. Qiratë 62
16. Aktive Afatgjata Jo-materiale 63
17. Aktivet afatgjata materiale të investuara 63
18. Inventari dhe aktive të tjera 64
19. Detyrime ndaj bankave 64
20. Detyrime ndaj klientëve 65
21. Tatimi i shtyrë 66
22. Provizionet 67
23. Detyrime të tjera 68
24. Kapitali aksioner dhe primi 68
25. Rezervat 68
26. Të ardhura nga interesi, neto 69
27. Të ardhura nga komisionet, neto 69
28. Të ardhura të tjera, neto 70
29. Shpenzime të tjera operative, neto 70
30. Shpenzime personeli 70
31. Shpenzime të tjera administrative 70
32. Shpenzime tatimi mbi fitimin 71
33. Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara 72
34. Palët e lidhura 73
35. Ngjarjet pas datës së bilancit 74

Tel: +355 4 2280124
Fax: +355 4 2280126
www.bdo.al

BDO Albania
Blvd. "Deshmoret e Kombit"
Twin Towers , Tower 2, 7th floor
Tirana- Albania

RAPORTI I AUDITUESVE TË PAVARUR

Drejtuar Menaxhimit dhe Aksionerit të Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a.

Opinioni

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a. ("Banka"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2020, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e fluksevе të parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozicionit financiar të Bankës më datë 31 Dhjetor 2020, dhe të performancës financiare të saj, dhe flukseve të parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Bazat për Opinionin tonë

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standarteve përshkruhen më tej në seksionin Përgjegjësitë e Audituesve për Auditimin e Pasqyrave Financiare të raportit tonë. Ne veprojmë në mënyrë të pavarur nga Banka në përputhje me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë ("Kodi IESBA") së bashku me kërkesat etike të cilat janë të rëndësishme për auditimin e pasqyrave financiare nga ana jonë në Shqipëri. Ne kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar paraqet një bazë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për opinionin tone.

Informacione të tjera

Informacionet e tjera përbëhen nga të dhëna që do të përfshihen në Raportin Vjetor të Bankës, krahas pasqyrave financiare dhe raportit tonë të auditimit. Drejtimi i Bankës është përgjegjës për informacionet dhe të dhënat e tjera. Raporti vjetor i bankës për vitin 2020 do të na vihet në dispozicion përpara datës së këtij raporti. Opinioni ynë për pasqyrat financiare nuk mbulon të dhënat dhe informacionet e tjera dhe ne nuk do të shprehim asnjë formë konkluzioni sigurie në lidhje me to. Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare nga ana jonë, përgjegjësia jonë është të lexojmë të dhënat dhe informacionet e tjera të përcaktuara më sipër në momentin që na vihen në dispozicion, dhe në këtë mënyrë të vlerësojmë nëse informacionet e tjera nuk janë në përputhje me pasqyrat financiare ose njohuritë që kemi përvetësuar gjatë auditimit apo në një mënyrë tjetër, në dukje rezultojnë që materialisht nuk janë paraqitur siç duhet. Gjatë leximit të raportit vjetor, nëse vërejmë se në të ekziston një gabim material, ne duhet të informojmë personat përgjegjës për drejtimin dhe qeverisjen në lidhje me çështjen.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe atyre të ngarkuar me Drejtimin për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrolle të brendshme, të cilat Drejtimi i përcakton të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali material, të cilat mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi.

Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Bankës për të vazhduar në vijimësi, paraqitjen, sipas rastit, të çështjeve që lidhen me vijimësinë dhe përdorimin e bazës kontabël të vijimësisë përveç rastit kur drejtimi ka si qëllim të likuidojë bankën ose të pushojë së zhvilluari operacionet dhe veprimtaritë e tij, ose kur nuk ka asnjë alternativë realiste tjetër përveç kësaj.

Personat e ngarkuari me drejtimin janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.

Përgjegjësitë e Audituesve për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë sigurimi i një besueshmërie të arsyeshme që pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe nxjerrja e raportit të audituesve që përfshin opinionin tonë. Besueshmëria e arsyeshme nënkupton një nivel më të lartë sigurie, por nuk përbën garanci për zbulimin e ndonjë anomalie materiale nga një auditim i kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Anomalitë mund të lindin nga mashtrimi apo gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato në mënyrë të arsyeshme mund të ndikojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të cilat janë marrë mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ne japim gjykimin tonë në mënyrë profesionale dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë riskun e gabimeve materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit të përgjegjshme për këto rreziqe dhe marrim dëshmi të auditimit të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë. Rreziku i mos-zbulimit të ndonjë gabimi material, që rezulton nga mashtrimi, është më i lartë se një që rrjedh nga gabimi, duke qenë se mashtrimi mund të përfshijë fshehje, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje e kontrollit të brendshëm.
- Kuptojmë kontrollin e brendshëm të përshtatshëm për auditimin me qëllim hartimin e procedurave të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Bankës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël që janë përdorur dhe arsyen e vlerësimeve, çmuarjeve kontabël dhe dhënien e informacioneve të ngjashme shpjeguese nga ana e drejtimit.
- Nxjerrim përfundimet mbi përshtatshmërinë e përdorimit nga Drejtimi i Bankës, të bazës kontabël të vijimësisë dhe, në bazë të dëshmive të marra të auditimit, nëse ekziston ndonjë pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime të konsiderueshme, në lidhje me aftësinë e Bankës për të vazhduar në vijimësi. Nëse ne arrijmë në përfundimin se ekziston një pasiguri materiale, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të audituesve për shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, ose, në qoftë se zbulimet të tilla janë të papërshtatshme, të ndryshojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në dëshmitë e auditimit të marra deri në datën e raportit të audituesve tanë. Megjithatë ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të bëjnë që Banka të ndalojë vazhdimin e aktiviteteve të saj.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare vjetore, duke përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare vjetore paraqesin në mënyrë të drejtë transaksionet dhe ngjarjet në funksion të një prezantimi të drejtë.

Ne komunikojmë me personat përgjegjës për drejtimin dhe qeverisjen, midis të tjerave në lidhje me qëllimin e planifikuar, kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, duke përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne identifikojmë gjatë auditimit tonë.

BDO ALBANIA SHPK

BDO Albania sh.p.k.
15 mars 2021
Tiranë, Shqipëri

BDO
BDO ALBANIA sh.p.k.
NIPT L02407004C
TIRANA - ALBANIA

Besjana Doda
Partniere Angazhimi

Intesa Sanpaolo Bank Albania Sh.a.
Pasqyra e Pozicionit Financiar më 31 dhjetor 2020
(në mijë Lek)

Pasqyra e Pozicionit Financiar

	Shënime	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Aktive			
Mjete monetare dhe të ngjashme	9	32,417,350	30,240,115
Hua dhe paradhënie bankave	10	26,736,572	29,146,303
Letra me vlerë të investimit	11	71,773,704	66,919,643
Hua dhe paradhënie klientëve	12	50,902,837	44,864,090
Aktive afatgjata që mbahen për tu shitur	13	-	20,711
Të drejta tatimore afatshkurtra		379,233	347,992
Ndërtesa dhe pajisje	14	1,915,582	2,211,673
Aktive me të drejtë përdorimi	15	601,159	460,883
Aktive afatgjata jo-materiale	16	489,831	600,977
Aktivet materiale afatgjata të investuara	17	533,798	545,556
Të drejta tatimore të shtyra		458,319	531,687
Inventari dhe mjete të tjera	18	2,425,088	1,682,647
Aktive gjithsej		**188,633,473**	**177,572,277**
Detyrimet			
Detyrime ndaj bankave	19	2,273,426	2,250,043
Detyrime ndaj klientëve	20	159,507,095	150,941,625
Detyrime qiraje	15	602,986	445,944
Detyrimet tatimore të shtyra	21	259,345	213,684
Provizione	22	835,305	1,065,558
Detyrime të tjera	23	2,103,547	1,018,663
Detyrime gjithsej		**165,581,704**	**155,935,517**
Kapitali aksionar			
Kapitali aksionar	24	5,562,518	5,562,518
Primet e aksioneve	24	1,383,880	1,383,880
Rezervat	25	6,303,154	6,169,157
Fitimi i pashpërndarë		9,802,217	8,521,205
Totali i Kapitalit Aksionar		23,051,769	**21,636,760**
Totali i Detyrimeve dhe Kapitalit Aksionar		188,633,473	**177,572,277**

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet në lidhje me shënimet shoqëruese nga faqja 6 deri në 74 të cilat janë pjesë integrale të pasqyrave financiare.

Pasqyra e fitim humbjeve dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse

	Shënime	2020	2019
Të ardhura nga interesat		4,110,416	4,326,621
Shpenzime për interesat		(878,851)	(888,984)
Të ardhura nga interesi, neto	26	**3,231,565**	**3,437,637**
Të ardhura nga komisionet		1,092,457	1,208,021
Shpenzime për komisionet		(320,515)	(355,321)
Të ardhura nga komisionet, neto	27	**771,942**	**852,700**
Të ardhura të tjera neto	28	540,109	548,308
Shpenzime të tjera operative, neto	29	(1,017,465)	(456,762)
Të ardhura operative		**3,526,151**	**4,381,883**
Zhvlerësimi i mjeteve financiare, neto	7(a)	(126,879)	(201,791)
Humbje nga zhvlerësimi /rikuperim nga aktivitete të tjera financiare	22	7,891	28,106
Zhvlerësimi i pronave te rimarra ne zotërim	18	565,988	267,260
Shpenzime personeli	30	(1,184,249)	(1,065,593)
Shpenzime operacionale qiraje	32	(15,789)	(47,783)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	14,16	(520,844)	(462,332)
Amortizimi i përmirësimeve të ambienteve me qira	18	(15,891)	(14,192)
Zhvlerësimi i aktiveve materiale afatgjata të investuara	17	(11,758)	-
Shpenzime të tjera administrative	31	(898,496)	(876,596)
Provizione për rreziqe dhe shpenzime	22	182,866	15,082
Totali i shpenzimeve		**(2,017,161)**	**(2,357,839)**
Fitimi neto para tatimit		**1,508,990**	**2,024,044**
Shpenzime për tatimin mbi fitimin	32	(214,456)	(322,170)
Fitimi i vitit		**1,294,534**	**1,701,874**
Të ardhura të tjera përmbledhëse			
Zëra që klasifikohen ose mund të klasifikohen më vonë në pasqyrën e fitim humbjeve			
Ndryshimi në vlerën e drejtë të letrave me vlerë të investimit në FVOCI		448,560	161,528
Tatimi përkatës		(67,284)	(24,095)
Zëra që nuk do të klasifikohen në pasqyrën e fitim humbjeve			
Ndryshimi në rivlerësimin e aktiveve afatgjata materiale funksionale, neto		(284,426)	-
Tatimi përkatës		42,664	-
Të ardhura të tjera përmbledhëse për periudhën, neto		**139,514**	**137,433**
Totali i të ardhurave të tjera përmbledhëse për periudhën, neto		**1,434,048**	**1,839,307**

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet në lidhje me shënimet shoqëruese nga faqja 6 deri në 74 të cilat janë pjesë integrale të pasqyrave financiare.

Pasqyra financiare e ndryshimeve në kapital

	Kapitali aksionar	Primet e aksioneve	Rezerva ligjore dhe rregullative	Rezerva e vlerës së drejtë	Rezerva e rivlerësimit	Rezerva të tjera të kapitalit	Rezerva e bashkimit	Fitimi i pashpërndarë	Totali
Gjendja më 1 janar 2020	**5,562,518**	**1,383,880**	**1,825,623**	**40,152**	**775,431**	**714,556**	**2,813,396**	**8,521,205**	**21,636,761**
Fitimi për periudhën	-	-	-	-	-	-	-	1,294,534	1,294,534
Të ardhura të tjera përmbledhëse									
Ndryshimi në vlerën e drejtë të letrave me vlerë të vendosjes të borxhit, pa tatimin mbi fitimin	-	-	-	375,759	-	-	-	-	375,759
Ndryshimi në rezervën e rivlerësimit	-	-	-	-	(241,762)	-	-		(241,762)
Ndryshimi i DTA në rezervën FTA	-	-	-	-	-	-	-	(13,523)	(13,523)
Totali i të ardhurave të tjera përmbledhëse	-	-	-	**375,759**	**(241,762)**	-	-	**(13,523)**	**120,474**
Transaksione me aksionarët të regjistruara direkt në kapitalin aksionar									
Dividendët për aksionarët	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Totali i kontributeve sipas shpërndarjes tek aksionarët	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	**5,562,518**	**1,383,880**	**1,825,623**	**415,911**	**533,669**	**714,556**	**2,813,396**	**9,802,216**	**23,051,769**

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet në lidhje me shënimet shoqëruese nga faqja 6 deri në 74 të cilat janë pjesë integrale të pasqyrave financiare.

Pasqyra financiare e ndryshimeve në kapital

	Kapitali aksionar	Primet e aksioneve	Rezerva ligjore dhe rregullative	Rezerva e vlerës së drejtë	Rezerva e rivlerësimit	Rezerva të tjera të kapitalit	Rezerva e bashkimit	Fitimi i pashpërndarë	Totali
Gjendja më 1 Janar 2019	**5,562,518**	**1,383,880**	**1,825,623**	**(97,281)**	**775,431**	**714,556**	**2,813,396**	**7,300,788**	**20,278,911**
Fitimi për periudhën	-	-	-	-	-	-	-	1,701,874	1,701,874
Të ardhura të tjera përmbledhëse									
Ndryshimi në vlerën e drejtë të letrave me vlerë të vendosjes të borxhit, pa tatimin mbi fitimin	-	-	-	137,433	-	-	-	-	137,433
Ndryshimi i DTA në rezervën FTA								(44,750)	(44,750)
Totali i të ardhurave të tjera përmbledhëse për periudhën	-	-	-	**137,433**	-	-	-	**(44,750)**	**92,683**
Transaksione me aksionarët të regjistruara direkt në kapitalin aksionar									
Dividendët për aksionarët	-	-	-	-	-	-	-	(436,707)	(436,707)
Totali i kontributeve sipas shpërndarjes tek aksionarët	-	-	-	-	-	-	-	(436,707)	(436,707)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	**5,562,518**	**1,383,880**	**1,825,623**	**40,152**	**775,431**	**714,556**	**2,813,396**	**8,521,205**	**21,636,761**

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet në lidhje me shënimet shoqëruese nga faqja 6 deri në 74 të cilat janë pjesë integrale të pasqyrave financiare.

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare

	2020	2019
Fitimi neto për vitin	**1,294,534**	**1,701,874**
Rregullime për:		
Zhvlerësimi dhe amortizimi	520,844	462,332
Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale të investuara	11,758	-
Pakësimi i ndërtesave dhe pajisjeve dhe mjeteve jo-materiale	-	32,332
(Rrimarrje)/zhvlerësimi i huave dhe paradhënieve për klientët, neto	126,879	201,791
Zhvlerësimi i inventarit	(565,988)	(267,260)
Të ardhura nga interesi, neto	(3,231,565)	(3,437,637)
Humbje nga zhvlerësimi i zërave jashtë bilancit, neto	(7,891)	(28,106)
Shpenzime për tatimet	214,456	322,170
Ndryshime në		
Hua dhe paradhënie bankave	2,409,731	(8,892,636)
Hua dhe paradhënie klientëve	(6,211,406)	(1,109,734)
Detyrime ndaj bankave	23,383	(512,376)
Detyrime ndaj klientëve	8,617,998	5,473,807
Aktive afatgjata që mbahen për tu shitur	20,711	1,111,961
Inventari dhe mjete të tjera	(207,695)	1,454,907
Detyrime të tjera dhe provizione	994,986	(128,517)
Të drejta tatimore të shtyra	(2,556)	171,620
Detyrime tatimore të shtyra	91,322	80,765
Interesi i arkëtuar	4,276,139	4,299,205
Interesi i paguar	(931,379)	(904,469)
Tatimi mbi fitimin i paguar	(183,213)	(525,831)
Fluksi neto i parasë nga/(përdorur në) aktivitetet operative	**7,261,048**	**(493,802)**
Fluksi i parasë nga aktivitetet investuese		
Blerja e ndërtesave dhe pajisjeve	(36,448)	(784,984)
Blerja e aktiveve afatgjata jo-materiale	(192,856)	(298,181)
Blerja e letrat me vlerë të investimit, neto	(4,854,509)	(3,036,517)
Fluksi neto i parasë përdorur në aktivitetet investuese	**(5,083,813)**	**(4,119,682)**
Fluksi i parasë nga aktivitetet financuese		
Dividendë të paguar aksionerëve	-	(436,707)
Fluksi neto i parasë përdorur në aktivitetet investuese	**-**	**(436,707)**
Rritja neto në mjete monetare dhe të ngjashme	**2,177,235**	**(5,050,191)**
Mjete monetare dhe të ngjashme më 1 janar	30,240,115	35,290,306
Mjete monetare e të ngjashme më 31 dhjetor	**32,417,350**	**30,240,115**

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare duhet të lexohet në lidhje me shënimet shoqëruese nga faqja 6 deri në 74 të cilat janë pjesë integrale të pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga Këshilli Drejtues i Bankës Intesa Sanpaolo Albania sh.a. në datën 12 mars 2021 dhe janë firmosur në emër të Bankës nga:

Silvio Pedrazzi
Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv

Julian Cela
Drejtor i Kontrollit Financiar

1. Subjekti raportues

Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a., (më poshtë referuar "Banka"), është një shoqëri e themeluar në Shqipëri. Banka, me seli në Tiranë, në adresën Rruga "Ismail Qemali", nr.27, ushtron aktivitetin e saj nëpërmjet një rrjeti të përbërë nga 35 degë dhe agjenci në qytete të ndryshme të Shqipërisë: Tiranë, Durrës, Vlorë, Elbasan, Fier, Berat, Gjirokastër, Korçë, Lushnje, Shkodër, Lezhë, Kavajë (2019: 35 degë dhe agjenci). Më 31 dhjetor 2020 Banka numëronte 657 punonjës (2019: 663).

2. Bazat e Përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Këto pasqyra financiare u autorizuan nga Drejtimi i Bankës më 12 mars 2021 dhe u paraqitën për miratim në Këshillin Drejtues.

3. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me parimin e kostos historike, duke bërë përjashtim vetëm për mjetet financiare që maten me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, aktivet materiale afatgjata të investuara dhe ndërtesat e veta në përdorim, të cilat janë të matura me vlerën e drejtë.

4. Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare janë të raportuara në Lek, e cila është në të njëjtën kohë edhe monedha funksionale dhe raportuese e Bankës. Me përjashtim të rasteve kur është specifikisht e shprehur, informacioni financiar i shprehur në Lek është rrumbullakosur në të mijtën më të afërt.

5. Përmbledhje e çmuarjeve dhe gjykimeve kontabël

Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare drejtimi ka bërë gjykimet, çmuarjet dhe supozimet të cilat prekin zbatimin e politikave kontabël të Bankës dhe vlerat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga këto çmuarje. Çmuarjet dhe supozimet në fjalë rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në mënyrë prospektive.

A. Gjykimet

Informacioni mbi gjykimet e bëra në zbatim të politikave kontabël, që kanë efektet më të rëndësishme në vlerat e njohura në pasqyrat financiare, është përfshirë në shënimet e mëposhtme.
-Shënimi 7. (a): vendosja e kritereve për përcaktimin nëse rreziku i kredisë për aktivin financiar është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, përcaktimin e metodologjisë për përfshirjen e informacionit të parashikuar në llogaritjen e Humbjeve të Pritshme të Kredisë (HPK), përzgjedhjen dhe miratimin e modeleve që përdoren për të llogaritur Humbjen e Pritshme të Kredisë.
-Shënimi 6. (f). (ii): klasifikimi i aktiveve financiare: vlerësimi i modelit të biznesit në bazë të të cilit mbahen aktivet dhe vlerësimi nëse kushtet kontraktuale të aktivit financiar parashikojnë flukse monetare të cilat përbëhen vetëm nga pagesa e principalit dhe e interesit për shumën e papaguar të principalit

B. Supozimet dhe pasiguritë e çmuarjeve

Informacioni në lidhje me supozimet dhe pasiguritë e çmuarjeve të cilat paraqesin një rrezik të lartë për të bërë rregullime materiale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 është përfshirë në shënimet e mëposhtme.
- Shënimi 7.(a): zhvlerësimi i instrumenteve financiare: përcaktimi i të dhënave në modelin e zhvlerësimit të humbjeve të pritshme të kredisë, duke përfshirë supozimet kryesore që përdoren për vlerësimin e flukseve monetare që mund të rikuperohen si dhe informacionin e parashikuar
- Shënimi 6.(f).(vi): përcaktimi i vlerës së drejtë të instrumenteve financiare me të dhëna të rëndësishme të panjohura
- Shënimi 6.(e).(ii): njohja e të drejtave tatimore të shtyra
- Shënimi 6.(r): njohja dhe matja e detyrimeve të kushtëzuara: supozimet kryesore mbi gjasat dhe madhësinë e një fluksi në dalje të burimeve
- Shënimi 6.(n): vlera e realizueshme e inventarit neto: matja e vlerës së drejtë me të dhëna të rëndësishme të panjohura

6. Përmbledhje e politikave kontabël

Politikat kontabël të përcaktuara më poshtë janë aplikuar në mënyrë të vijueshme për të gjithë periudhat e pasqyrave financiare nga Banka.

(a) Monedha e huaj

Transaksionet e këmbimeve valutore janë kthyer në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të vlefshëm në datën e transaksioneve.

Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj, në datën e raportimit, janë këmbyer në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të vlefshëm në datën e këmbimit. Fitimi ose humbja nga këmbimet valutore të zërave monetar, është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës, rregulluar për interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj, të këmbyer me kursin e këmbimit të ditës në fund të periudhës. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare të cilat janë matur me vlerën e drejtë në monedhë të huaj, këmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të vlefshëm në datën e përcaktimit të vlerës se drejtë.

Instrumentet jo-monetare, të cilat janë matur në përputhje me parimin e kostos historike në një monedhë të huaj, janë konvertuar me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Diferencat e konvertimit të cilat rezultojnë nga rikonvertimet, njihen në pasqyrën e të ardhurave. Diferencat e konvertimit të cilat rezultojnë nga këmbimet valutore me aksionaret, regjistrohen direkt në kapitalin aksionar.

(b) Interesat

Norma efektive e interesit

Të ardhurat dhe shpenzimet e interesit njihen në pasqyrën e të ardhurave me anë të metodës së normës efektive të interesit. Norma efektive e interesit është norma e cila bën aktualizimin e flukseve të pagesave dhe arkëtimeve të pritshme në të ardhmen gjatë jetëgjatësisë së pritshme deri në

- shumën e mbartur të aktivit financiar; ose
- koston e amortizuar të detyrimit financiar

Për llogaritjen e normës efektive të interesit për instrumentet financiare përveç aktiveve të blera ose të gjeneruara të zhvlerësuara, Banka vlerëson rrjedhën e parasë në të ardhmen duke marrë në konsideratë të gjitha kushtet kontraktuale të instrumenteve financiare, por jo humbjet e pritshme nga kredia në të ardhmen. Për aktivet financiare të blera ose të gjeneruara të zhvlerësuara, norma efektive e interesit e rregulluar llogaritet duke përdorur rrjedhën e parasë të çmuar duke përfshirë humbjet nga kredia në të ardhmen. Llogaritja e normës efektive të interesit përfshin të gjitha komisionet e paguara ose të arkëtuara, shpenzimet për transaksionet, dhe zbritjet ose primet që janë pjesë e normës efektive të interesit. Shpenzimet e transaksionit janë shpenzime shtesë që i atribuohen në mënyrë direkte blerjes, emetimit ose shitjes se një aktivi ose detyrimi financiar.

Kostoja e amortizuar dhe shuma e mbartur bruto

Kosto e amortizuar e aktivit ose detyrimit financiar përbën shumën me të cilën aktivi dhe detyrimi financiar matet në fazën e njohjes fillestare, minus kthimin e principalit, plus ose minus vlerën e amortizimit të akumuluar, duke përdorur metodën e interesit efektiv, për të gjitha ndryshimet midis shumës fillestare që është njohur dhe shumës së maturuar dhe, për aktivet financiare, duke zbritur ndonjë humbje të pritshme nga zhvlerësimi i kredive. Shuma bruto e mbartur e një aktivi financiar, përbën koston e amortizuar të aktivit financiar përpara rregullimit për ndonjë humbje të pritshme nga zhvlerësimi i kredive.

6. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(b) Interesat (vazhdim)

Llogaritja e të ardhurave nga interesi dhe shpenzimeve të interesit

Norma efektive e interesit të një aktivi ose detyrimi financiar matet në fazën e njohjes fillestare të aktivit dhe detyrimit financiar. Për llogaritjen e të ardhurave nga interesi dhe shpenzimeve të interesit, norma efektive e interesit aplikohet për shumën e mbartur bruto të aktivi (nëse aktivi nuk zhvlerësohet) ose për koston e amortizuar të detyrimit. Norma efektive e interesit rishikohet si një rezultat i ri-çmuarjes së fluksit të mjeteve monetare ose instrumenteve me normë të ndryshueshme për të pasqyruar lëvizjet në normat e interesit të tregut.

Megjithatë, për aktivet financiare të cilat janë zhvlerësuar pas njohjes fillestare, të ardhurat nga interesi maten duke aplikuar normën efektive të interesit për koston e amortizuar të aktivit financiar. Nëse aktivi nuk vazhdon të zhvlerësohet më tej, atëherë matja e të ardhurave nga interesi do të bëhet në bazë të vlerës bruto.

Për aktivet financiare të cilat janë zhvlerësuar në fazën e njohjes fillestare, të ardhurat nga interesi maten duke aplikuar normën efektive të interesit të rregulluar të kredisë për koston e amortizuar të aktivit. Matja e të ardhurave nga interesi nuk aplikohet sipas metodës për shumën bruto, edhe nëse rreziku i kredisë së aktivit përmirësohet.

Për informacion mbi fazën e zhvlerësimit të aktiveve financiare, shihni Shënimin 6(f)(vii).

Paraqitja

Të ardhurat nga interesi të cilat llogariten duke përdorur metodën e normës efektive të interesi dhe paraqiten në pasqyrën e të ardhurave dhe në pasqyrën e fitim humbjeve dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse përfshijnë:

- interesat për aktivet financiare dhe detyrimet financiare të cilat maten me kosto të amortizuar
- interesat për instrumentet e borxhit të cilat maten me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse;
- të ardhura të tjera nga interesi të cilat paraqiten në pasqyrën e fitim humbjeve dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse përfshijnë të ardhura nga interesi që gjenerohen nga qiratë.

Shpenzimet për interesa që paraqiten në pasqyrën e të ardhurave përfshijnë shpenzimet për interesat nga detyrimet financiare të cilat maten me kosto të amortizuar.

(c) Komisionet

Të ardhurat dhe shpenzimet nga komisionet, që janë pjesë integrale e normës efektive të interesit të një aktivi ose detyrimi financiar, përfshihen në përcaktimin e normës efektive të interesit (shih shënimin 6 (b)).

Të ardhurat e tjera nga komisionet, përfshirë komisionet e shërbimit të llogarisë, komisionet për drejtim investimi, komisionet për shitje dhe vendosje depozite, njihen në momentin e kryerjes së shërbimeve. Nëse angazhimi për një hua nuk pritet të zvogëlojë huanë, atëherë komisionet e angazhimit të huasë njihen në mënyrë lineare përgjatë kohëzgjatjes së angazhimit.

Një kontratë me një klient që rezulton në një instrument financiar të njohur në pasqyrat financiare të Bankës, mund të përfshihet pjesërisht në standardin SNRF 9 dhe pjesërisht në standardin SNRF 15. Në këtë rast, Banka në fillim do të aplikojë standardin SNRF 9 për të ndarë dhe matur pjesën e kontratës që përfshihet në standardin SNRF 9, dhe më pas për pjesën që mbetet aplikon standardin SNRF 15.

Shpenzime të tjera nga komisionet lidhen kryesisht me komisionet për transaksione dhe shërbime, të cilat kalojnë në shpenzime në momentin e marrjes së shërbimit të ofruar.

6. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(d) Qiratë

Në fillimin e një kontrate, Banka vlerëson nëse një kontratë është, ose përmban, një qira. Një kontratë është, ose përmban, një qira nëse kontrata parashikon të drejtën për të kontrolluar përdorimin e një aktivi të përcaktuar për një periudhë kohe në këmbim të një pagese.

Politika zbatohet për kontratat që lidhen (ose janë ndryshuar) në ose pas datës 1 janar 2019.

i. Banka në cilësinë e qiramarrësit

Në momentin e fillimit ose modifikimit të një kontrate që përmban një përbërës qiraje, Banka i cakton pagesën në kontratë, secilit përbërës të qirasë, në bazë të çmimeve përkatëse. Sidoqoftë, për marrjen me qira të mjediseve të degëve dhe zyrave, Banka ka vendosur që të mos ndajë përbërësit jo të qirasë dhe llogaritë për përbërësit e qirasë dhe përbërësit jo të qirasë si një përbërës i vetëm i qirasë.

Banka e njeh aktivin me të drejtë përdorimi dhe detyrimin e qirasë në datën e fillimit të qirasë. Aktivi me të drejtë përdorimi matet fillimisht me kosto, e cila përfshin shumën fillestare të detyrimit të qirasë, të rregulluar për të gjitha pagesat e qirasë të bërë në ose para datës së fillimit, plus çdo kosto fillestare direkte që është kryer dhe një çmuarje të kostove për çmontimin dhe heqjen e përmirësimeve dhe ndërhyrjeve të bëra në mjediset e degëve ose të zyrave.

Aktivi me të drejtë përdorimi zhvlerësohet më pas nëpërmjet përdorimit të metodës lineare, nga data e fillimit deri në fund të afatit të qirasë. Gjithashtu, aktivi me të drejtë përdorimi skontohet në mënyrë periodike për humbjet nga zhvlerësimi, nëse ka, dhe rregullohet për matje të caktuara të detyrimit të qirasë.

Detyrimi i qirasë matet fillimisht me vlerën aktuale të pagesave të qirasë që nuk janë paguar në datën e fillimit, të cilat skontohen duke përdorur normën e interesit të përfshirë në qira ose, nëse kjo normë nuk mund të përcaktohet me lehtësi, normën rritëse të huamarrjes së bankës. Në përgjithësi, Banka përdor si normë skontimi normën e saj rritëse të huamarrjes.

Banka përcakton normën e saj rritëse të huamarrjes duke analizuar huamarrjet e saj nga burime të ndryshme të jashtme dhe bën rregullime të caktuara për të pasqyruar afatet e qirasë dhe llojin e aktivit të marrë me qira.

Pagesa e qirasë, që përfshihet në matjen e detyrimit të qirasë, përbëhet nga sa më poshtë vijon:

- pagesa fikse, duke përfshirë pagesa fikse në substancë;
- pagesa të ndryshueshme të qirasë që varen nga një indeks ose norma, e cila matet fillimisht duke përdorur indeksin e normës në datën e fillimit;
- shumat që pritet të paguhen në bazë të një garancie të vlerës së mbetur; dhe
- çmimi i ushtrimit sipas opsionit të blerjes që Banka në mënyrë të arsyeshme është e sigurt për ta ushtruar, pagesat e qirasë gjatë një periudhe rinovimi opsionale nëse Banka në mënyrë të arsyeshme vendos të ushtrojë opsionin për zgjatjen e afati, dhe penalitetet për përfundimin e parakohshëm të afatit të qirasë, përveçse kur Banka në mënyrë të arsyeshme nuk është e sigurt për të zgjidhur kontratën para afatit.

Detyrimi i qirasë matet me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Ajo rimatet nëse ka një ndryshim në pagesat e qirasë në të ardhmen që rezultojnë nga ndryshimi i indeksit ose normës, nëse ka një ndryshim në vlerësimin e Bankës për shumën që parashikohet të paguhet në bazë të garanci të vlerës së mbetur, nëse Banka ndryshon vlerësimin e saj në lidhje me ushtrimin e opsionit të blerjes, zgjatjes së afatit ose përfundimit të kontratës ose nëse ka një pagesë të rishikuar të qirasë fikse në substancë.

Kur detyrimi i qirasë rimatet në këtë mënyrë, në vlerën kontabël të aktivit me të drejtë përdorimi bëhet rregullimi përkatës, ose regjistrohet në pasqyrën e fitim humbjeve nëse vlera kontabël e aktivit me të drejtë përdorimi zvogëlohet në zero.

6. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(d) Qiratë (vazhdim)

i. Banka në cilësinë e qiramarrësit (vazhdim)

Banka paraqet aktivet me të drejtë përdorimi dhe detyrimet e qirasë si pjesë e "detyrimeve të tjera" në pasqyrën e pozicionit financiar.

Qira afatshkurtra dhe qira të aktiveve me vlerë të ulët.

Banka ka vendosur të mos njohë aktivet me të drejtë përdorimi dhe detyrimet e qirasë, për qiratë e aktiveve me vlerë të lartë dhe qiratë afatshkurtra. Banka njeh pagesat e qirasë që shoqërohen me këto qira si shpenzime në mënyrë lineare përgjatë afatit të qirasë.

ii. Banka në cilësinë e qiradhënësit

Në momentin e fillimit ose modifikimit të një kontrate që përmban një përbërës qiraje, Banka i cakton pagesën në kontratë secilit përbërës të qirasë në bazë të çmimit specifik.

Kur Banka vepron si qiradhënës, në fillimin e qirasë përcakton nëse qiraja është një qira financiare ose një qira operative.

Për të klasifikuar qiratë, Banka bën një vlerësim të përgjithshëm nëse qiraja transferon në mënyrë thelbësore të gjitha rreziqet dhe përfitimet rastësore për pronësinë e qirasë në fjalë. Si pjesë e këtij vlerësimi, Banka merr në konsideratë tregues të caktuar si për shembull: nëse qiraja është për pjesën kryesore të jetës ekonomike të aktivit.

Banka zbaton kërkesat e për mosnjohjen dhe zhvlerësimin sipas SNRF 9 për investimin neto në qira. Gjithashtu, Banka rishikon rregullisht vlerat e mbetura të pa garantuara të cilat janë përdorur për llogaritjen e investimit bruto në qira.

6. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(e) Tatimi mbi fitimin

Shpenzimet për tatimin mbi fitimin përfshijnë tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi i periudhës aktuale dhe tatimi i shtyrë njihen në pasqyrën e të ardhurave me përjashtim kur i referohet zërave të cilët njihen direkt në kapital ose tek të ardhurat e tjera përmbledhëse. Interesat dhe gjobat që lidhen me tatimin mbi të ardhurat, duke përfshirë trajtimet e pasigurta tatimore, njihen sipas SNK 37 Provizionet, Pasivet dhe Aktivet e Kushtëzuara

(i) Tatimi aktual

Tatimi aktual përfshin tatimin që pritet të paguhet ose të arkëtohet për të ardhurat e tatueshme ose shpenzimet për periudhën, dhe çdo rregullim të tatimit që duhet të paguhet ose të arkëtohet në lidhje me vitet e mëparshme. Shuma e tatimit aktual që pritet të paguhet ose të arkëtohet është çmuarja më e mirë e vlerës së tatimit që pritet të paguhet ose të arkëtohet, e cila reflekton pasiguritë në lidhje me tatimin mbi të ardhurat. Tatimi aktual matet duke përdorur normat e taksave në fuqi ose të cilat hyjnë në fuqi në datën e raportimit.

Të drejtat dhe detyrimet tatimore aktuale kompensohen vetëm nëse plotësohen disa kritere.

(ii) Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë përllogaritet mbi diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës së mbartur të të drejtave dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe shumat që përdoren për qëllime tatimore.

Aktivet tatimore të shtyra njihen për humbjet tatimore të papërdorura, kreditimet tatimore dhe diferencat tatimore të zbritshme, deri në atë nivel ku është e mundshme që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i vlefshëm kundrejt të cilit mund të përdoren këto aktive tatimore të shtyra. Të ardhurat e tatueshme në të ardhmen, përcaktohen në bazë të rikthimit të diferencave të përkohshme përkatëse të tatueshme. Nëse shuma e diferencave të përkohshme të tatueshme nuk është e mjaftueshme për njohjen e plotë të një të drejte tatimore të shtyrë, atëherë të ardhurat e tatueshme në të ardhmen, të cilat rregullohen për rikthimin e diferencave të përkohshme ekzistuese, vlerësohen në bazë të planeve të biznesit. Aktivet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen deri në atë nivel që nuk ka më mundësi që të realizohet fitimi nga tatimet; këto zbritje anulohen në fazën e përmirësimit të probabilitetit të të ardhurave të tatueshme në të ardhmen.

Aktivet tatimore të shtyra rivlerësohen në çdo datë raportimi dhe njihen deri në atë masë që fitimi i tatueshëm i ardhshëm, do të jetë i vlefshëm kundrejt të cilit të përdoren këto aktive tatimore të shtyra.

Tatimi i shtyrë matet me normat e taksave të cilat janë parashikuar të zbatohen mbi diferencat e përkohshme në momentin e kthimit të tyre, duke përdorur normat e taksave në fuqi ose që hyjnë në fuqi në datën e raportimit.

Matja e tatimit të shtyrë pasqyron pasojat tatimore që ndjekin mënyrën sipas të cilës Banka parashikon, në fund të periudhës së raportimit, të rikuperojë ose likuidojë vlerën e mbartur të të drejtave dhe detyrimeve të saj.

6. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(f) Aktivet dhe detyrimet financiare

(i) Njohja dhe matja fillestare

Banka fillimisht njeh huatë dhe paradhëniet, depozitat dhe letrat me vlerë të borxhit në datën kur ato janë krijuar. Të gjitha instrumentet e tjera financiare (përfshirë Blerjet dhe shitjet e rregullta të aktiveve financiare) njihen fillimisht në datën e tregtimit në të cilën Banka bëhet palë për respektimin e dispozitave kontraktuale të instrumentit.

Aktivi ose detyrimi financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë plus, për një instrument që nuk matet me vlerë të drejtë nëpërmjet pasqyrës së të ardhurave, kostot e transaksionit të cilat i atribuohen direkt blerjes ose emetimit të tij

(ii) Klasifikimi

Në fazën e njohjes fillestare, Banka klasifikon një aktiv financiar të matur me koston e amortizuar, vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse (VDATP) dhe vlerës së drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (VDPFH).

Aktivi financiar matet me koston e amortizuar nëse plotëson të dyja kushtet e mëposhtme dhe nuk përcaktohet me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (VDPFH):

- aktivi mbahet në një model biznesi, objektivi i të cilit është që të mbajë aktivet për të arkëtuar flukset e mjeteve monetare kontraktuale;

- termat dhe kushte kontraktuale të aktivit financiar krijojnë në data të caktuara flukse monetare të llojit "vetëm pagesa principali dhe interesi" (testi VPPI).

Instrumenti i borxhit matet me vlerën e drejtë, nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse, nëse ai plotëson të dyja kushtet e mëposhtme dhe nuk përcaktohet me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (VDPFH):

- aktivi mbahet në një model biznesi, objektivi i të cilit arrihet nëpërmjet arkëtimit të flukseve monetare kontaktuale dhe shitjes së aktiveve financiare;

- termat kontraktuale të aktivit financiar krijojnë flukse monetare në data të caktuara, të llojit "vetëm pagesa principali dhe interesi" (testi VPPI).

Në fazën e njohjes fillestare të një investimi në kapital i cili nuk mbahet për qëllime tregtimi, Banka në mënyrë të parevokueshme mund të vendosë të paraqesë ndryshimet në vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse. Ky vendim merret rast pas rasti sipas investimeve.

Të gjitha aktivet e tjera financiare klasifikohen të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (VDPFH).

Gjithashtu, në fazën e njohjes fillestare, Banka në mënyrë të parevokueshme mund të vendosë që një aktiv financiar, i cili i plotëson ndryshe kushtet, të matet me kosto të amortizuar ose me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse ose me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, nëse në këtë mënyrë eliminon ose zvogëlon ndjeshëm papajtueshmërinë kontabël që mund të rezultojë.

6. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(f) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(ii) Klasifikimi (vazhdim)

Vlerësimi i modelit të biznesit

Banka ka bërë një vlerësim të qëllimit të modelit të biznesit në të cilin një aktiv financiar mbahet në nivel portofoli sepse pasqyron më mirë mënyrën e menaxhimit të biznesit dhe paraqitjen e informacionit drejtuesve. Informacioni që është marrë në konsideratë përfshin:

- politikat dhe objektivat e deklaruara për portofolin dhe zbatimin e këtyre politikave në praktikë. Në veçanti, nëse strategjia e menaxhimit fokusohet tek gjenerimi i të ardhurave nga interesat kontraktuale, ruajtja e një profili të veçantë të normës së interesit, përputhja e kohëzgjatjes së aktiveve financiare me kohëzgjatjen e detyrimeve që financojnë aktivet ose realizojnë flukse monetare nëpërmjet shitjes së aktiveve;
- mënyrën e vlerësimit të ecurisë së portofolit dhe raportimit tek drejtimi i bankës;
- rreziqet që cenojnë ecurinë e modelit të biznesit (dhe aktivet financiare që mbahen në këtë model biznesi) dhe strategjia e saj për mënyrë e menaxhimit të këtyre rreziqeve;
- si kompensohen menaxherët e biznesit (p.sh. nëse kompensimi bazohet me vlerën e drejtë të aktiveve që menaxhohen ose fluksin e mjeteve monetare kontraktuale që arkëtohen);
- periodicitetin, volumin dhe kohën e shitjeve në periudhat e mëparshme, arsyet për këto shitje, dhe pritshmëritë e saj për aktivitetin e shitjeve në të ardhmen. Megjithatë, informacioni dhe të dhënat për aktivitetin e shitjes, nuk vlerësohet në mënyrë të izoluar por si pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të mënyrës së arritjes nga ana e Bankës, të objektivave të deklaruara për menaxhimin e aktiveve financiare dhe realizimit të flukseve monetare.

Aktivet financiare që mbahen për qëllime tregtimi ose menaxhohen, ecuria e të cilave vlerësohet në bazë të vlerës së drejtë, maten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes sepse ato nuk mbahen as për të arkëtuar flukse monetare kontraktuale dhe as për të arkëtuar flukse monetare kontraktuale dhe për të shitur aktive financiare.

Vlerësimi nëse flukset monetare kontraktuale përbëhen vetëm nga pagesa e principalit dhe e interesit.

Për qëllime të këtij vlerësimi, 'principali' përcaktohet si vlera e drejtë e aktivit financiar në fazën e njohjes fillestare. 'Interesi' përcaktohet si pagesa për vlerën në kohë të parasë dhe për rrezikun e kredisë që shoqëron shumën e principalit të papaguar gjatë një periudhe të caktuar kohe dhe për rreziqe dhe kostot e tjera kryesore të kredidhënies, si dhe marzhin e fitimit.

Në vlerësimin nëse flukset monetare kontraktuale janë të përbëra vetëm nga pagesa e principalit dhe interesit, Banka ka marrë në konsideratë kushtet kontraktuale të instrumentit, i cili përfshin vlerësimin nëse aktivi financiar përmban një term kontraktual që mund të ndryshojë kohën ose shumën e flukseve të mjeteve monetare kontraktuale në mënyrë që të mos plotësojë këtë kusht. Gjatë vlerësimit, Banka merr në konsideratë:

- ngjarjet e kushtëzuara që do të ndryshojnë shumën dhe kohën e flukseve të mjeteve monetare;
- karakteristikat e levës financiare;
- parapagimin dhe zgjatjen e afateve;
- afatet që kufizojnë pretendimet e bankës për flukse monetare për aktive të veçanta (p.sh. hua jo-rekurs);
- dhe karakteristikat që modifikojnë pagesën e vlerës në kohë të parasë (p.sh. rivendosja periodike e normave të interesit).

6. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(f) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(ii) Klasifikimi (vazhdim)

Riklasifikimet

Aktivet financiare nuk riklasifikohen pas njohjes së tyre fillestare, me përjashtim të periudhës pasi Banka ndryshon modelin e saj të biznesit për menaxhimin e aktiveve financiare.

Detyrimet financiare

Banka i klasifikon detyrimet e saj financiare si detyrime financiare të tjera, të matura më pas me koston e tyre të amortizuar.

Shih shënimet 6.(p).

(iii) Çregjistrimi

Aktivet financiare

Banka nuk e njeh më një aktiv financiar, nëse të drejtat kontraktuale për flukset e parave nga aktivi janë shuar, ose nëse transferohen të drejtat për të marrë përfitimin kontraktual nga aktivi financiar në një transaksion nëpërmjet të cilit transferohen të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë mbi aktivin financiar, ose kur banka nuk transferon dhe nuk mban asnjë nga rreziqet apo përfitimet e pronësisë si dhe nuk ruan kontrollin ndaj aktivit financiar.

Për mos-njohjen e një aktivi financiar, diferenca midis vlerës së mbartur të aktivit (ose vlerës së mbartur që i caktohet pjesës së aktivit të çregjistruar/fshirë) dhe shumës së (i) pagesës së arkëtuar (përfshirë çdo aktiv të ri të përfituar duke i zbritur detyrimin e ri të presupozuar) dhe (ii) fitimit ose shpenzimeve të akumuluara që njihen tek të ardhura të tjera përmbledhëse, njihet në pasqyrën e të ardhurave. Çdo interes në aktivet financiare të transferuara, të cilat plotësojnë kriteret për mos-njohjen e tyre, që krijohet ose mbahet nga Banka, njihet si një aktiv ose detyrim më vete.

Banka kryen transaksione nëpërmjet të cilave transferon aktivet e njohura në pasqyrën e pozicionit financiar, por mban të gjitha ose në thelb të gjitha rreziqet dhe shpërblimet e aktiveve të transferuara, apo ndonjë pjesë të tyre. Në këto raste, aktivet e transferuara vazhdojnë të njihen në pasqyrën e pozicionit financiar. Si shembull të këtyre transaksioneve përmendim huadhënien e letrave me vlerë dhe transaksionet e marrëveshjeve të riblerjes.

Në transaksionet në të cilat Banka nuk mban dhe as transferon në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së një aktivi financiar dhe ruan kontrollin mbi aktivin, Banka vazhdon të njohë aktivin deri në masën e përfshirjes së saj të vazhdueshme, të përcaktuar sipas masës në të cilën ai është i ekspozuar ndaj ndryshimeve të vlerës së aktivit të transferuar.

Detyrimet financiare

Banka çregjistron një detyrim financiar, kur detyrimet kontraktuale janë shfuqizuar, anuluar ose kur u skadon afati.

(iv) Modifikimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare

Aktivet financiare

Nëse termat dhe kushtet e një aktivi financiar modifikohen, atëherë Banka vlerëson nëse flukset e mjeteve monetare të aktivit të modifikuar janë në thelb të ndryshme.

6. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(f) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(iv) Modifikimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare (vazhdim)

Nëse flukset e mjeteve monetare janë thelbësisht ndryshe, atëherë të drejtat kontraktuale për flukset monetare nga aktivi financiar fillestar konsiderohen të shuara. Në këtë rast, aktivi financiar fillestar nuk njihet (shih (iii)) dhe një aktiv financiar i ri njihet me vlerë të drejtë së bashku me të gjitha kostot e pranueshme të transaksionit. Të gjitha komisionet e arkëtuara si pjesë e modifikimit kontabilizohen si më poshtë vijon:

- komisionet të cilat merren në konsideratë për përcaktimin e vlerës së drejtë të një aktivi të ri dhe komisionet të cilat përfaqësojnë rimbursimin e kostove të pranueshme të transaksionit, përfshihen në matjen fillestare të aktivit; dhe

- komisionet e tjera, përfshihen në pasqyrën e fitim humbjeve si pjesë e fitimit ose humbjeve që rezulton nga mos-njohja e aktivit.

Nëse flukset monetare modifikohen kur huamarrësi është në vështirësi financiare, atëherë qëllimi i modifikimit është zakonisht të maksimizojë rikuperimin e kushteve kontraktuale fillestare, në vend të gjenerimit të një aktivi të ri me kushte thelbësisht të ndryshme. Nëse Banka planifikon të modifikojë një aktiv financiar sipas një mënyre e cila do të sjell faljen e flukseve monetare, atëherë së pari Banka vlerëson nëse një pjesë e aktivit duhet të fshihet përpara se të kryhet modifikimi (shih në vijim politikën për fshirjen nga bilanci). Kjo qasje ndikon në rezultatin e vlerësimit sasior dhe nënkupton që kriteret për mos-njohjen e aktivit nuk përmbushen dhe plotësohen në këto raste.

Nëse modifikimi i një aktivi financiar, i cili matet me kosto të amortizuar ose me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse, nuk sjell mos-njohjen e aktivit financiar, atëherë Banka në fillim do të rillogarisë vlerën e mbartur bruto të aktivit financiar, duke përdorur normën efektive të interesit fillestar të aktivit dhe njeh rregullimin që rezulton si të ardhura ose shpenzime nga modifikimi në pasqyrën e të ardhurave. Për aktive financiare me normë të ndryshueshme, norma efektive e interesit fillestar, që përdoret për të llogaritur dhe matur të ardhura ose shpenzimet, rregullohet për të reflektuar kushtet aktuale të tregut në kohën e modifikimit.

Të gjitha kostot ose komisionet që paguhen dhe komisionet që arkëtohen si pjesë e modifikimit rregullojnë vlerën e mbartur bruto të aktivit financiar të modifikuar dhe amortizohen përgjatë afatit të mbetur të aktivit financiar të modifikuar.

Nëse modifikimi kryhet për shkak të vështirësive financiare të huamarrësit (shih 6.f.(vii)), atëherë të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten së bashku në humbje nga zhvlerësimi. Në raste të tjera, ajo paraqitet si të ardhura nga interesi, të llogaritura nëpërmjet metodës së normës efektive të interesit (shih 6 (b).

Detyrimet financiare

Banka nuk e njeh një detyrim financiar në fazën kur kushtet e tij modifikohen dhe flukset monetare të detyrimit të modifikuar ndryshojnë në mënyrë thelbësore. Në këtë rast, një detyrim financiar i ri në bazë të kushteve të modifikuara njihet me vlerën e drejtë. Diferenca midis vlerës së mbartur të detyrimit financiar që nuk është njohur dhe pagesës së kryer njihet në pasqyrën e të ardhurave. Pagesa e kryer përfshin aktive jo financiare të transferuara, nëse ka, dhe supozimin e detyrimeve, duke përfshirë detyrimin e ri financiar të modifikuar.

Nëse modifikimi i një detyrimi financiar nuk kontabilizohet si mos-njohje, atëherë kostoja e amortizimit të detyrimit llogaritet duke aktualizuar flukset monetare të modifikuara me normën efektive të interesit fillestar dhe të ardhurat ose shpenzimet që rezultojnë njihen në pasqyrën e të ardhurave. Për detyrimet me norma të ndryshueshme, norma efektive e interesit fillestar që përdoret për të llogaritur dhe matur të ardhurat ose shpenzimet për modifikimin, rregullohet për të reflektuar kushtet aktuale të tregut në kohën e modifikimit. Të gjitha kostot dhe komisionet që paguhen, njihen si rregullim i shumës së mbartur të detyrimit dhe amortizohen gjatë afatit të mbetur të detyrimit financiar të modifikuar, duke ri-llogaritur normën efektive të interesit të instrumentit.

6. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(f) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(v) Kompensimi

Aktivet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe vlera neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar kur dhe vetëm kur Banka gëzon të drejtën ligjore për të bërë kompensimin e shumave dhe vlerave, dhe ka si qëllim likuidimin mbi bazën neto ose likuidimin e aktivit dhe shlyerjen e detyrimit njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten neto vetëm nëse lejohen nga standardet e kontabilitetit, ose për fitime apo humbje të cilat rezultojnë nga realizimi i transaksioneve të ngjashme në aktivitetin tregtar të Bankës.

(vi) Matja me vlerën e drejtë

Vlera e drejtë është çmimi që përfitohet nga shitja e një aktivi ose që paguhet për të transferuar një detyrim, nëpërmjet një transaksioni të rregullt midis pjesëmarrësve në treg në datën e matjes, në kapital, ose në mungesë të tij në tregun më të mirë në të cilin Banka ka akses në atë datë. Vlera e drejtë e një detyrimi pasqyron rrezikun e mospagimit të tij.

Sipas rastit, Banka mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimin e kuotuar në një treg aktiv për atë instrument. Një treg konsiderohet aktiv nëse transaksionet për aktivin ose detyrimin ndodhin me një periodicitet dhe volum të mjaftueshëm për të siguruar në mënyrë të vazhdueshme të dhëna dhe informacion për çmimin.

Nëse në tregun aktiv nuk ka një çmim të kuotuar, atëherë Banka përdor teknikat e vlerësimit të cilat maksimizojnë përdorimin e të dhënave përkatëse të njohura dhe do të minimizojë përdorimin e të dhënave të panjohura. Teknikat e vlerësimit që janë zgjedhur, përfshijnë të gjithë faktorët që pjesëmarrësit në treg do të marrin në konsideratë për vlerësimin e çmimit të një transaksioni.

Treguesi më i mirë e vlerës së drejtë të një instrumenti financiar në njohjen fillestare është zakonisht çmimi i transaksionit, p.sh. vlera e drejtë e pagesës së kryer ose të arkëtuar. Nëse Banka vendos se vlera e drejtë në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit dhe se vlera e drejtë nuk përcaktohet nga një çmim i kuotuar në një treg aktiv, për një aktiv ose detyrim të ngjashëm, dhe as nuk bazohet në një teknikë vlerësimi që përdor të dhëna njohura në tregje, atëherë instrumenti financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë dhe rregullohet për diferencën midis vlerës së drejtë në njohjen fillestare dhe çmimit të transaksionit. Në vijim, diferenca njihet në fitim humbje siç duhet gjatë kohëzgjatjes së instrumentit, por jo më vonë se periudha kur vlerësimi është plotësisht i mbështetur me të dhëna të njohura në treg ose kur mbyllet transaksioni.

Vlera e drejtë e një depozite pa afat nuk është më e vogël se shuma që paguhet në momentin e kërkesës, e cila zbritet nga data e parë kur do të kërkohej pagesa e depozitës.

Banka njeh transferimet midis niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë, në fund të periudhës së raportimit gjatë të cilës ka ndodhur ndryshimi.

6. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(f) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(vii) Zhvlerësimi

Banka njeh humbjet nga zhvlerësimi për humbjet e pritshme nga kreditë të instrumenteve të mëposhtëm financiarë, të cilët nuk maten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitim humbjeve:

- aktivet financiare që janë instrumente të borxhit;
- kontratat për garancitë financiare të dhëna; dhe
- angazhimet e huasë së dhënë.

Banka mat humbjen nga zhvlerësimi me një vlerë të barabartë me jetëgjatësinë e humbjes së pritshme nga kredia, me përjashtim të sa më poshtë vijon, të cilat maten si humbje të pritshme të kredisë 12 mujore:

- letrat me vlerë të investimit të borxhit të cilat vlerësohen të kenë një rrezik të ulët kredie në datën e raportimit; dhe
- instrumente të tjera financiare, për të cilat rreziku i kredisë nuk është rritur ndjeshëm nga momenti i njohjes së tyre fillestare.

Banka vlerëson se një letër me vlerë e investimit të borxhit ka një rrezik të ulët kredie në momentin kur vlerësimi i rrezikut të kredisë i saj është ekuivalent me përkufizimin e pranuar gjerësisht të "nivelit të investimit". Banka nuk aplikon përjashtimin e rrezikut të ulët të kredisë për ndonjë nga instrumentet e tjera financiare.

Humbjet e pritshme nga kredia 12 mujore, përbëjnë pjesën e humbjeve të pritshme nga kredia që rezulton nga ngjarjet e mospagimit për një instrument financiar, të cilat janë të mundshme brenda një periudhe 12 mujore pas datës së raportimit. Instrumentet financiare për të cilat njihen humbjet e pritshme nga kredia 12 mujore, referohen si 'instrumente financiare të nivelit 1'.

Humbjet e pritshme të kredisë gjatë kohëzgjatjes, janë humbje të pritshme të kredisë që rezultojnë nga të gjitha ngjarjet e mundshme të mospagimit përgjatë kohëzgjatjes së pritshme të instrumentit financiar. Instrumentet financiare, për të cilat humbjet e pritshme të kredisë gjatë kohëzgjatjes së tyre njihen por nuk zhvlerësohen, referohen si 'instrumente financiare të nivelit 2'.

Matja e humbjeve të pritshme të kredisë

Humbjet e pritshme të kredisë përbëjnë një vlerësim të probabilitetit të ponderuar të humbjeve nga kreditë. Ato maten si më poshtë vijon:

- *aktivet financiare që nuk zhvlerësohen në datën e raportimit:* si vlera aktuale e të gjitha mjeteve monetare (p.sh. diferenca midis flukseve të mjeteve monetare për shkak të njësisë ekonomike, në përputhje me kontratën dhe flukset e mjeteve monetare që Banka pret të marrë);
- *aktivet financiare që zhvlerësohen në datën e raportimit*: diferenca midis vlerës kontabël bruto dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme të vlerësuara;
- *huadhënie të aprovuara por jo të disbursuara:* si vlera aktuale e diferencës midis flukseve monetare kontraktuale, të cilat duhet t'i paguhen bankës nëse huaja disbursohet dhe flukseve monetare që banka parashikon të arkëtojë; dhe
- *kontratat për garanci financiare*: pagesat e pritshme për të rimbursuar mbajtësin, duke zbritur çdo shumë që Banka pret të rikuperojë.

Shih gjithashtu Shënimin 7(a).

Aktivet financiare të zhvlerësuara

Në çdo datë raportimi, Banka vlerëson nëse aktivet financiare që maten me kosto të amortizuar dhe aktivet financiare të borxhit që maten me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse janë zhvlerësuar. Një aktiv financiar zhvlerësohet, nëse ka ndodhur një ose më shumë ngjarje të cilat kanë patur një ndikim jo të favorshëm në flukset e ardhshme monetare të çmuara të aktivit.

6. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(f) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(vii) Zhvlerësimi (vazhdim)

Aktivet financiare të zhvlerësuara (vazhdim)
Treguesi që një aktiv financiar është zhvlerësuar, përfshin të dhënat e mëposhtme të njohura:

- vështirësitë financiare të konsiderueshme të huamarrësit ose emetuesit;
- shkelja e detyrimeve të kontratës si për shembull ngjarja e mospagimit ose pagesë e vonuar;
- ristrukturimin e një huaje ose paradhënie nga Banka, për shkak të vështirësive financiare të klientit dhe me kushte që Banka nuk mund të shqyrtojë ndryshe;
- tregues që një huamarrës do të falimentojë ose të jetë subjekt i riorganizimit financiar; ose
- zhdukja e një tregu aktiv për një letër me vlerë, për shkak të vështirësive financiare

Një hua që është rinegocuar për shkak të përkeqësimit të kushteve të huamarrësit, në përgjithësi konsiderohet e zhvlerësuar nëse nuk ekziston treguesi që rreziku i mosarkëtimit të flukseve monetare kontraktuale është ulur ndjeshëm dhe nëse nuk ka asnjë tregues tjetër të zhvlerësimit. Në vlerësimin nëse një investim në borxhin shtetëror është zhvlerësuar, Banka merr në konsideratë faktorët e mëposhtëm:

- Vlerësimin e besueshmërisë së tregut, sikundër pasqyrohet në yield-et e obligacioneve
- Vlerësimet e besueshmërisë sipas agjencive të klasifikimit.
- Aftësia e vendit për të vlerësuar tregjet e kapitalit për emetimin e borxhit të ri.
- Probabiliteti i ristrukturimit të borxhit, i cili do të sjellë humbje për mbajtësit nëpërmjet faljes vullnetare ose të detyrueshëm të borxhit.
- Miratimi i mekanizmave ndërkombëtare të mbështetjes për t'i ofruar vendit asistencën e nevojshme si "kreditor i resortit të fundit", si dhe qëllimi, i reflektuar në deklaratat publike të qeverive dhe agjencive për të përdorur këto mekanizma. Kjo përfshin një vlerësim të thellësisë së këtyre mekanizmave dhe pavarësisht nga qëllimi politik, nëse ka kapacitetin për të plotësuar kriteret e duhura.

Paraqitja e zhvlerësimit për humbjet e pritshme të kredisë në pasqyrën e pozicionit financiar
Zhvlerësimi i humbjeve për humbjet e pritshme të kredisë, paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar si më poshtë:

- *Aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar*: si zbritje nga vlera kontabël bruto e aktiveve;
- *Kontratat për angazhimet e huasë dhe garancitë financiare*: në përgjithësi si një provizion;
- *Nëse një instrument financiar përfshin elementin e disbursuar dhe të padisbursuar, dhe Banka nuk mund të identifikojë humbjen e pritshme të kredisë për elementin e angazhimit të kredisë veçmas nga ato për elementin e disbursuar*: Banka paraqet një zhvlerësim të kombinuar të humbjes për të dy elementët. Shuma e kombinuar paraqitet si një zbritje nga vlera kontabël bruto e elementit të disbursuar. Çdo tejkalim i zhvlerësimit të humbjes, mbi shumën bruto të elementit të disbursuar, paraqitet si një provizion; dhe
- *Instrumentet e borxhit të matur me vlerën e drejtë në të ardhurat e tjera përmbledhëse*: asnjë zhvlerësim i humbjeve nuk njihet në pasqyrën e pozicionit financiar sepse vlera kontabël e këtyre aktiveve është vlera e drejtë e tyre. Megjithatë, zhvlerësimi i humbjes paraqitet dhe njihet në rezervën e vlerës së drejtë

Fshirja e huave

Huatë dhe letrat me vlerë të borxhit fshihen (pjesërisht ose plotësisht) nëse nuk ka asnjë pritshmëri të arsyeshme për rikuperimin e aktivit financiar në tërësinë e tij ose të një pjese të tij. Në përgjithësi është rasti kur banka vendos nëse huamarrësi nuk ka aktive ose burime të të ardhurave të cilat mund të gjenerojnë flukse monetare, të mjaftueshme për të ripaguar shumat që janë subjekt i fshirjes. Vlerësimi realizohet në nivelin e aktivit individual. Rikuperimi i shumave të fshira më parë, përfshihen në "zhvlerësimin e humbjeve të instrumenteve financiare" në pasqyrën e fitim humbjeve dhe tek të ardhurat e tjera përmbledhëse.

Aktivet financiare që janë fshirë, mund të vijojnë të jenë ende subjekt i aktiviteteve të ekzekutimit të garancisë, në zbatim të procedurave të Bankës për rikuperimin e shumave që duhet të paguhen.

6. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(g) Mjete monetare dhe të ngjashme

'Mjete monetare dhe të ngjashme' përfshijnë mjetet në arkë, llogaritë me bankat, gjendjet e pakufizuara me bankat qendrore dhe depozitat afatshkurtra shume likuide me maturitet më pak se tre muaj, të cilat janë subjekt i ndryshimeve jo të rëndësishme të vlerës së tyre të drejtë dhe përdoren nga Banka për përmbushjen e angazhimeve të saj afatshkurtra.

Mjete monetare dhe të ngjashme mbahen në pasqyrën e pozicionit financiar me koston e amortizuar.

(h) Hua dhe paradhënie

Paraqitja e huave dhe paradhënieve, në pasqyrën e pozicionit financiar, përfshijnë huatë dhe paradhëniet e matura me kosto të amortizuar. Ato maten në fillim me vlerën e drejtë dhe më pas me koston e amortizimit, plus kostot e tjera të transaksioneve direkte, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Kur Banka shet një aktiv financiar dhe njëkohësisht nënshkruan një marrëveshje për të riblerë aktivin (ose një aktiv thelbësisht të ngjashëm) me një çmim fiks në një datë në të ardhmen ("reverse repo" ose "stock borrowing"), marrëveshja kontabilizohet si një kredi ose paradhënie, dhe aktivi financiar nuk njihet në pasqyrat financiare të Bankës.

(i) Investime në Letra me Vlerë

Paraqitja e 'investimeve në letra me vlerë' në pasqyrën e pozicionit financiar përfshin:

- letrat me vlerë të investimit të borxhit që maten me kosto të amortizuar (shih g (ii)); Ato maten në fillim me vlerën e drejtë dhe më pas me koston e amortizimit, plus kostot e tjera të transaksioneve direkte, duke përdorur metodën e interesit efektiv;
- letra me vlerë të borxhit që maten me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse

Për letrat me vlerë të borxhit të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse, të ardhurat dhe shpenzimet njihen tek të ardhurat e tjera përmbledhëse, me përjashtim të sa më poshtë vijon, të cilat njihen në pasqyrën e fitim humbjeve në të njëjtën mënyrë si për aktivet financiare të cilat maten me kosto të amortizuar:

- Të ardhurat nga interesi duke përdorur metodën e interesit efektiv
- Humbjet e pritshme të kredisë dhe rimarrjet, si dhe
- Të ardhurat dhe shpenzimet nga këmbimi valutor

Nëse letra me vlerë e borxhit, e matur me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse nuk njihet, fitimi ose humbja e akumuluar e njohur më parë tek të ardhurat e tjera përmbledhëse riklasifikohet nga kapitali në fitim humbje.

6. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(j) Aktive afatgjata që mbahen për tu shitur

Aktivet afatgjata për të cilat ka filluar procesi i shitjes, klasifikohen si aktive që mbahen për tu shitur nëse ka mundësi të mëdha që ato do të rikuperohen kryesisht nëpërmjet shitjes se sa nëpërmjet përdorimit të saj në vazhdim. Këto aktive maten në përgjithësi me vlerën më të ulët të shumës kontabël dhe vlerës së drejtë, duke i zbritur kostot e shitjes.

(k) Ndërtesat dhe pajisjet

(i) Njohja dhe matja

Ndërtesat dhe pajisjet paraqiten me koston e tyre neto pasi iu është zbritur zhvlerësimi i akumuluar dhe ndonjë humbje nga zhvlerësimi. Ndërtesat maten me vlerën e rivlerësuar, e cila është vlera e drejtë në datën e rivlerësimit, minus zhvlerësimin e akumuluar dhe çdo humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Nëse një pjesë e rëndësishme e një aktivi ose pajisje kanë jetëgjatësi përdorimi të ndryshme, atëherë këto pjesë kontabilizohen si elementë të veçanta (përbërësit kryesor) të ndërtesave dhe pajisjeve. Të gjitha fitimet ose humbjet nga shitja e një ndërtese dhe pajisje njihet me të ardhurat e tjera në fitim humbje

(ii) Kostot vijuese

Kostot vijuese kapitalizohen nëse është e mundur që të sigurohen përfitime të ardhshme ekonomike për Bankën. Kostot e riparimit dhe të mirëmbajtjes njihen si shpenzime kur kryhen.

(iii) Zhvlerësimi

Zhvlerësimi përllogaritet për të fshirë koston e zërit të ndërtesave dhe pajisjeve, minus vlerën e mbetur të tyre, që është parashikuar duke përdorur metodën lineare gjatë gjithë kohëzgjatjes dhe në përgjithësi njihet në pasqyrën e të ardhurave. Trualli dhe Veprat e Artit nuk zhvlerësohen. Jetëgjatësitë e parashikuara të përdorimit për periudhën aktuale dhe periudhën krahasuese janë të paraqitura si më poshtë:

	2020	2019
• Ndërtesat	20 deri në 33 vjet	20 deri në 33 vjet
• Kompjuterët dhe pajisje të tjera kompjuterike	4 deri në 8 vjet	4 deri në 8 vjet
• Mobiliet, orenditë dhe pajisjet	3 deri në 10 vjet	3 deri në 10 vjet
• Aktive të tjera jo elektrike	5 vjet	5 vjet

(l) Aktive Afatgjata Jo-materiale

Programet kompjuterike, licencat dhe markat tregtare përbëjnë aktivet afatgjata jo-materiale dhe paraqiten me koston neto nga amortizimi i akumuluar. Shpenzimet e mëtejshme në aktivet afatgjata jo-materiale, kapitalizohen vetëm nëse këto shpenzime rrisin të mirat e ardhshme ekonomike të këtij mjeti specifik. Çdo lloj kostoje tjetër shpenzohet në periudhën në të cilën kryhet. Amortizimi pasqyrohet të pasqyra e të ardhurave duke përdorur metodën lineare të amortizimit për të gjithë jetëgjatësinë e aktiveve afatgjata jo-materiale, duke filluar nga data e përdorimit të tyre. Jetëgjatësia e parashikuar e përdorimit për periudhën aktuale dhe krahasuese vijon si më poshtë:

	2020	2019
• **Programe komjuterike**	5 vjet	5 vjet
• **Licencat dhe markat tregtare**	10 vjet	10 vjet

(m) Aktivet materiale afatgjata të investuara

Aktivet materiale afatgjata të investuara, fillimisht maten me metodën e kostos dhe më pas me vlerën e drejtë, ku çdo ndryshim i vlerës do të njihet në fitim ose humbje brenda të ardhurave të tjera. Të gjitha të ardhurat ose humbjet nga shitja e aktiveve materiale afatgjata të investuara (e përllogaritur si diferenca midis të ardhurave neto nga shitja dhe vlerës së mbartur të aktivit) njihen në pasqyrën e të ardhurave.

Kur përdorimi i një aktivi ndryshon në mënyrë të tillë që të riklasifikohet si ndërtesa dhe pajisje, vlera e drejtë e saj, në datën e riklasifikimit do të konsiderohet kosto për kontabilitetin e ardhshëm.

6. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(n) Inventari

Inventari përfshin aktivet e rimarra në pronësi përmes ekzekutimit të garancisë për huatë me probleme dhe paradhëniet e klientëve të cilët nuk sigurojnë të ardhura, nuk përdoren nga Banka dhe janë planifikuar për shitje brenda një kohe të shkurtër të arsyeshme, pa ristrukturim të konsiderueshëm. Aktivet e rimarra në pronësi, paraqiten me vlerën e tyre më të ulët të realizueshme dhe fshirja e tyre njihet në pasqyrën e të ardhurave.

(o) Zhvlerësimi i aktiveve jo financiare

Në çdo datë raportimi, Banka rishikon vlerën e mbartur të aktiveve jo financiare (të ndryshme nga inventari dhe të drejtave tatimore të shtyra), për të përcaktuar nëse ka tregues të zhvlerësimit. Në rast se rezultojnë tregues të tillë, atëherë përllogaritet vlera e rikuperueshme e aktivit. Humbja nga zhvlerësimi njihet, nëse vlera e mbartur e një aktivi tejkalon shumën e rikuperimit. Vlera e rikuperueshme e një aktivi është më e madhja prej vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë, minus kostot për t'u shitur. Për vlerësimin e vlerës në përdorim, fluksi i të ardhurave të parashikuara, skontohet në vlerë aktuale me normën e zbritjes para tatimit e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut me vlerën në kohë të parasë dhe risqet specifike të aktivit. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim humbje. Humbjet nga zhvlerësimi rimerren vetëm kur shuma e mbartur e aktivit, nuk e tejkalon shumën e mbartur që do të ishte përcaktuar, pa zhvlerësimin ose amortizimin, nëse nuk do të njihej asnjë humbje nga zhvlerësimi.

(p) Depozitat

Depozitat përbëjnë burimet e financimit të Bankës.

Depozitat fillimisht maten me vlerën e drejtë plus kostot direkte të transaksionit dhe me pas maten me koston e tyre të amortizuar, duke përdorur metodën e normës efektive të interesit.

Kur Banka shet një aktiv financiar dhe njëkohësisht nënshkruan një marrëveshje për të riblerë aktivin (ose një aktiv të ngjashëm) me një çmim fiks në një datë në të ardhmen ("repo" ose "stock lending"), marrëveshja kontabilizohet si depozitë, dhe aktivi në fjalë vazhdon të njihet në pasqyrat financiare të Bankës.

(q) Provizionet

Një provizion mund të njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje në të kaluarën, Banka disponon një detyrim ligjor ose konstruktiv që mund të vlerësohet me besueshmëri dhe që gjithashtu është e mundur që të kërkojë dalje të përfitimeve ekonomike për të mbyllur detyrimin. Provizionet përcaktohen duke përdorur si normë skontimi, për flukset e pritshme të parasë në të ardhmen, një norme para taksës e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe aty ku është e përshtatshme edhe specifikat e riskut për detyrimin.

Një provizion për taksat për bankë njihet kur plotësohet kushti që shkakton pagesën e taksës. Nëse detyrimi i nënshtrohet një minimumi të aktivitetit, në mënyrë që ngjarja obliguese të arrijë një aktivitet minimal, atëherë një provizion njihet kur arrihet pragu minimal i aktivitetit.

Një provizion për ristrukturimin njihet kur Banka ka miratuar një plan të detajuar dhe formal strukturimi dhe ristrukturimi ka filluar ose është njoftuar publikisht. Humbjet operacionale në të ardhmen nuk janë parashikuar.

6. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(r) Garancitë financiare dhe angazhimet e huasë

Garancitë financiare janë kontrata për të cilat Banka duhet të bëjë pagesa të caktuara për të rimbursuar mbajtësin, për një humbje që ajo shkakton sepse një debitor i caktuar nuk arrin të kryej pagesën në kohën e duhur, në përputhje me kushtet e një instrumenti borxhi. Angazhimet e kredisë janë angazhime të qëndrueshme për të ofruar kredi, sipas afateve dhe kushteve të paracaktuara.

Garancitë financiare të lëshuara ose angazhimet për të siguruar një hua me një normë interesi nën nivelin e tregut fillimisht maten me vlerën e drejtë. Më pas, ato maten si më poshtë:

- me vlerën më ta madhe të fondit për humbjet nga zhvlerësimet i përcaktuar sipas SNRF 9 dhe shuma e njohur në fillim minus, sipas rastit, shumën e akumuluar e të ardhurave të njohura në përputhje me parimet e SNRF 15.

Për angazhime të tjera të huasë:

- Banka njeh fondin për humbjet nga zhvlerësimi

Detyrimet që lindin nga garancitë financiare dhe angazhimet e huasë përfshihen tek provizionet.

(s) Përfitimet e punonjësve

(i) Planet e përcaktuara të kontributeve

Banka operon vetëm me kontribute të detyrueshme të sigurimeve shoqërore që sigurojnë përfitime pensioni për personelin, në momentin e daljes në pension. Autoritetet lokale janë përgjegjës për të siguruar minimumin e nivelit të pensionit, sipas ligjit për pensionet në Shqipëri, në bazë të një plani të përcaktuar kontributi për pensionin. Kontributet e Bankës, ndaj përfitimeve të planit të pensionit, pasqyrohen në pasqyrën e të ardhurave në momentin kur ndodhin.

(ii) Përfitimet afatshkurtra

Detyrimet për përfitimet afatshkurtër të punonjësve, llogariten mbi një bazë të paskontueshme dhe njihen si shpenzime kur shërbimi përkatës është siguruar. Një provizion njihet për vlerën e pritur për t'u paguar, në bazë të një plani shpërblimi afat-shkurtër në mjete monetare ose plani për ndarjen e fitimit nëse Banka ka një detyrim aktual ligjor ose konstruktiv për të paguar ketë shumë si rezultat i një shërbimi të kryer në të kaluarën nga punonjësi dhe ky detyrim mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

(t) Standarde dhe interpretime të reja ende jo në fuqi

Një numër standardesh të reja, ndryshime të standardeve dhe interpretimeve, janë në fuqi për periudhat vjetore duke filluar pas datës 1 Janar 2020; megjithatë, Banka për përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare nuk ka zbatuar paraprakisht standardet e reja dhe të amenduara që vijojnë më poshtë.

Standardet e mëposhtme të ndryshuara nuk parashikohen të kenë një ndikim të konsiderueshëm në pasqyrat financiare të Bankës:

- Kontratat që paraqesin vështirësi - Kostoja për përmbushjen dhe zbatimin e një kontrate (Amendimet e SNK 37).
- Koncesionet për qiranë si rezultat i situatës së krijuar nga COVID-19 (Amendimet e SNRF 16)
- Ndërtesat, mjetet dhe pajisjet: Të ardhurat përpara përdorimit të synuar (Amendimet e SNK 16).
- Referenca për Kuadrin Konceptual të Standardeve (Amendimet e SNRF 3).
- Klasifikimi i Detyrimeve në detyrime afat-shkurtra dhe afat-gjata (Amendimet e SNK 1).
- SNRF 17 Kontratat e Sigurimit dhe amendimet e SNRF 17 Kontratat e Sigurimit.

7. Administrimi i Riskut Financiar

Si pasojë e përdorimit të instrumenteve financiare, Banka ekspozohet ndaj risqeve te mëposhtëm:

a. risku i kredisë
b. risku i likuiditetit
c. risku i tregut
d. risku operacional

Ky shënim jep informacion rreth ekspozimit të Bankës ndaj secilit prej llojeve të risqeve, objektivat e Bankës, politikat dhe proceset për vlerësimin dhe administrimin e riskut si dhe administrimin e kapitalit të Bankës

Kuadri i Administrimit të Riskut

Këshilli Drejtues i Bankës ka përgjegjësinë kryesore për krijimin dhe mbikëqyrjen e kuadrit të administrimit të riskut të Bankës. Këshilli Drejtues ka krijuar Komitetet e Qeverisjes së Bankës (Komitetin e Drejtuesve Ekzekutiv, Komitetin e Kredisë, Komitetin e Aktivit dhe Pasivit, Komitetin e Riskut Operacional, Komitetin e Administrimit të Riskut të Kredisë, Komitetin e Kredive me Probleme dhe komitete të tjera) të cilat kanë autoritetin për vendimmarrje sipas fushave të tyre të caktuara.

Divizioni i Administrimit të Riskut është përgjegjës për zhvillimin dhe monitorimin e politikave të administrimit të riskut të Bankës në këto fusha. Të gjitha komitetet e Bankës kanë anëtarë ekzekutiv dhe jo ekzekutiv dhe raportojnë rregullisht tek Këshilli Drejtues për aktivitetet e tyre. Politikat e administrimit të riskut të Bankës, janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar riskun me të cilin përballet Banka, për të vendosur limitet dhe kontrollin e duhur, si dhe për të monitoruar risqet dhe zbatimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e administrimit të riskut rishikohen rregullisht, për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut, si dhe produktet dhe shërbimet e ofruara.

(a) Risku i kredisë

Në aktivitetin normal të biznesit të saj, Banka është e ekspozuar ndaj riskut të kredisë në huadhëniet dhe paradhëniet ndaj klientëve dhe institucioneve financiare, investimet në letra me vlerë dhe zërave të tjerë jashtë bilancit. Risku i kredisë është risku i një humbjeje financiare të Bankës, nëse një klient ose palë e ngjashme që posedon një instrument financiar dështon në përmbushjen e detyrimeve kontraktore që burojnë nga huadhënia e Bankës ndaj klientëve, letra me vlerë të borxhit, financime me institucione të tjera financiare ose që burojnë nga zëra të tjerë jashtë bilancit. Për arsye raportimi të administrimit të riskut, Banka konsideron dhe konsolidon të gjithë elementet e ekspozimit ndaj riskut të kredisë (si risku individual i mospërmbushjes së detyrimeve, risku i sektorëve të ekonomisë si dhe risku lokal). Banka e administron ekspozimin e saj ndaj riskut te kredisë në mënyrë periodike, duke monitoruar nga afër limitet e kredisë, portofolin e huave dhe përqendrimin e ekspozimit.

Gjatë vitit 2020, për të përballuar situatën emergjente të krijuar si rezultat i pandemisë COVID-19, banka ka zbatuar moratoriumin për shtyrjen e pagesave të kësteve nga muaji mars deri në shtator 2020 sipas kërkesave të paraqitura nga klientët.

Në tabelën më poshtë paraqitet një përmbledhje e ekspozimeve që i nënshtrohen moratoriumit për secilin nivel deri në fund të muajit Dhjetor 2020.

	31 Dhjetor 2020			
Hua dhe paradhënie klientëve	**Niveli 1**	**Niveli 2**	**Niveli 3**	**Totali**
Aplikimet për moratoriumin Covid-19	16,754,699	576,496	102,802	**17,433,997**
Nuk aplikuan për moratoriumin Covid-19	33,114,901	140,493	2,254,192	**35,509,585**
Totali	**49,869,600**	**716,989**	**2,356,994**	**52,943,583**

Gjithashtu, banka ka nënshkruar me Qeverinë Shqiptare dy garanci sovrane të cilat janë përdorur për të lehtësuar kreditimin e personave juridikë të prekur nga izolimi, një masë konservatore e cila u morr për shkak të kushteve të përgjithshme të pandemisë.

7. Administrimi i Riskut Financiar (vazhdim)

(a) Risku i kredisë (vazhdim)

Garancia e parë: "Kredi për pagat në bazë të Garancisë Sovrane (Garancia Sovrane 1) - Limiti: 900,000,000 lekë, e cila kishte si qëllim marrjen e kredive nga personat juridikë për të paguar pagat e punonjësve të stafit të tyre. Garancia e dytë: "Kreditimi në bazë të Garancisë Sovrane për Kapital Qarkullues dhe Investime (Garancia Sovrane 2) - Limiti: 1,200,000,000 lekë që kishte si qëllim marrjen e kredive nga personat juridikë për të financuar nevojat e tyre të përkohshme për likuiditet (Kapital qarkullues) ose për të kryer investimet e nevojshme si rrjedhojë e pandemisë.

7. Administrimi i Riskut të Kredisë (vazhdim)

(a) Risku i kredisë

Në tabelën më poshtë paraqitet një përmbledhje e ekspozimeve të siguruara me garancitë sovrane:

	31-Dhjetor-20			
Hua dhe paradhënie klientëve	**Niveli 1**	**Niveli 2**	**Niveli 3**	**Totali**
Dhënë në bazë të Garancisë Sovrane 1	482,985	0	0	**482,985**
Dhënë në bazë të Garancisë Sovrane 2	461,212	0	0	**461,212**
Të pasiguruar me Garancia Sovrane	48,925,403	716,989	2,356,994	**51,999,386**
Totali	**49,869,600**	**716,989**	**2,356,994**	**52,943,583**

(i) Administrimi i Riskut të Kredisë

Këshilli Drejtues i Bankës i ka deleguar përgjegjësi për marrjen e vendimeve Komiteteve të Riskut. Njësia për Administrimin e Riskut, e cila raporton tek Drejtori Përgjithshëm Ekzekutiv ('DPE'), është përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe administrimin e riskut të kredisë së Bankës, duke përfshirë detyrat e mëposhtme:

- *Formulimin e politikave të kredisë* duke u konsultuar me njësitë e biznesit, mbulimin e kërkesave për kolateral, vlerësimin e kredisë, përcaktimin e nivelit të riskut dhe raportimin e tij, procedurat e dokumentimit dhe ato ligjore, si dhe përputhshmërinë me kërkesat rregullative dhe statutore.
- *Rishikimin dhe vlerësimin e riskut të kredisë.* Departamenti i Riskut të Kredisë vlerëson të gjitha ekspozimet e kredisë, përpara angazhimit me klientë nga Banka. Rinovimet dhe rishikimet e kushteve të kredive janë objekt i të njëjtit proces rishikimi.
- *Kufizimin e përqendrimit të ekspozimit* sipas palëve, vendndodhjes dhe industrisë, (për huadhënie dhe paradhënie) si dhe sipas lëshuesit, kategorisë së klasifikimit të kredisë, likuiditetit të tregut dhe vendit (për investimet në letrat me vlerë).

7. Administrimi i Riskut Financiar (vazhdim)

(a) Risku i kredisë (vazhdim)

(i) Administrimi i Riskut të Kredisë (vazhdim)

- *Zhvillimin dhe mirëmbajtjen e klasifikimit të riskut të Bankës* në mënyrë që të kategorizojë ekspozimet sipas nivelit të riskut të humbjes financiare që përballet si dhe të fokusojë administrimit e risqeve të tjerë shoqërues. Klasifikimi i riskut përdoret për të përcaktuar nevojën e provigjionimit të dëmeve ndaj ekspozimeve specifike të kredisë

  Në përputhje me metodologjinë e Bankës, të gjitha ekspozimet janë të klasifikuara si ekspozime pa probleme (përfshirë nivelin 1 dhe nivelin 2) dhe me probleme (nivelin 3 - përfshirë Në ndjekje, Të strukturuara dhe Të dyshimta). Banka klasifikon portofolin e ekspozimeve pa probleme në dy grupe, Niveli 1 dhe Niveli 2, në bazë të një grupi rregullash të harmonizuara me udhëzimet e Grupit Intesa Sanpaolo, nisur nga shenjat e përkeqësimit të ekspozimit sipas specifikave të mëposhtme:

Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3
• Ekspozime pa probleme pa ditë vonesa • **Ekspozime pa probleme me më pak se 30 ditë vonesë**	• Ekspozime pa probleme me më shumë se 30 ditë vonesë • Ekspozime pa probleme me vonesa • Ekspozime pa probleme që tregojnë shenja të paralajmërimit të hershëm (portokalli, e kuqe dhe blu e lehtë) dhe PCM.	• Ekspozime me më shumë se 90 ditë vonesë • Të strukturuara • Të dyshimta

  Banka klasifikon portofolin e ekspozimeve me probleme, duke i analizuar ato në bazë të një grupi rregullash të harmonizuara me udhëzimet e Grupit Intesa Sanpaolo. Këto rregulla përfshijnë faktet objektive si: shkelja e kontratës (moskryerja e pagesave të interesit dhe principalit); vështirësi të mëdha financiare të huamarrësit; dhe informacione të tjera të rëndësishme financiare për klientin.

  Duke filluar nga data 1 nëntor 2019, Banka ka prezantuar kriteret e reja të klasifikimit të një ekspozimi me probleme, në përputhje me Udhëzimet e Autoritetit Bankar Europian (ABE) për zbatimin e kritereve të reja të klasifikimit të ekspozimeve me probleme (ABE/GL/2016/07) dhe Standardet Teknike Rregullatore për zbatimin e për pragun e rëndësisë, (ABE/RTS/2016/06) të cilat përcaktojnë se si duhet të aplikohen kriteret e përcaktimit të ekspozimit me probleme. Në bazë të këtyre udhëzimeve janë vendosur pragjet e reja në lidhje me rëndësinë, pragu relativ prej 1% të ekspozimit në mjete monetare të debitorit dhe një prag absolut për nivelin e debitorit, të barabartë me 500 euro, për ekspozimet e klientëve jo individ dhe 100 euro për ekspozimet e klientëve individ. Numri i ri i ditëve të vonesave, të cilat përdoren si kriter objektiv për klasifikimin në nivelin 2 (më shumë se 30 ditë vonesë) dhe klasifikimi sipas ditë vonesave (më shumë se 90 ditë vonesë), kontabilizohen në mënyrë rritëse kur shkelen të dy pragjet, relative dhe absolute. Gjithashtu, në momentin që debitori nuk kryhen pagesën, ai do të mbetet në statusin me probleme për të paktën 90 ditë, deri në momentin kur nuk ka asnjë shenjë mospagese. Gjithashtu është prezantuar dhe një stimul i ri i strukturimit për ristrukturimet me probleme nga të cilat është hequr dorë, vlera neto e të cilave ka rënë me më shumë se 1%, në krahasim me marrëveshjen e mëparshme. Përcaktimi i kritereve të reja të klasifikimit të një ekspozimi me probleme, u kontabilizuan në mënyrë prapavepruese, duke filluar nga data 1 nëntor 2019.

- *Rishikimi i përputhshmërisë* së njësive të biznesit me limitet e ekspozimit të miratuara duke përfshirë ato për industritë e zgjedhura dhe llojet e produkteve. Në Komitetin e Aktiveve me Probleme, paraqiten çdo muaj analiza të detajuara për cilësinë e kredisë të ekspozimeve të klientëve, si dhe propozime për veprimet rregulluese të duhura që duhen ndërmarrë.

- *Ofrimin e konsultave, udhëzimeve dhe aftësive profesionale* ndaj njësive të biznesit, për të promovuar në Bankë praktikën më të mirë të administrimit të riskut të kredisë.

7. Administrimi i Riskut Financiar (vazhdim)

(a) Risku i kredisë (vazhdim)

(iii) Cilësia e kredisë sipas kategorive të aktiveve financiare

Në tabelat e mëposhtme paraqitet informacioni mbi cilësinë e kredisë së aktiveve financiare të matura me kosto të amortizuar, investime të borxhit të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse. Përveçse kur përcaktohet në mënyrë specifike, për aktivet financiare, shumat në tabelë përfaqësojnë shumat e mbartura bruto. Shpjegimi i termave 'Niveli 1', 'Niveli 2' dhe 'Niveli 3' përfshihet në Shënimin 6(g)(vii).

				31 Dhjetor 2020
	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Totali
Hua dhe paradhënie klientëve				
Pa probleme	49,824,618	716,989	-	50,541,607
Në ndjekje	-	-	136,760	136,760
Të strukturuara	-	-	845,467	845,467
Të dyshimta	-	-	1,374,767	1,374,767
Totali	**49,824,618**	**716,989**	**2,356,994**	**52,898,601**
Provizionet për humbjen	**480,387**	**229,916**	**1,285,461**	**1,995,764**
Vlera kontabël	**49,344,231**	**487,073**	**1,071,533**	**50,902,837**

				31 Dhjetor 2019
	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Totali
Hua dhe paradhënie klientëve				
Pa probleme	43,720,062	635,684	-	44,355,746
Në ndjekje	-	-	104,414	104,414
Të strukturuara	-	-	1,466,978	1,466,978
Të dyshimta	-	-	951,266	951,266
Totali	**43,720,062**	**635,684**	**2,522,658**	**46,878,404**
Provizionet për humbjen	**710,117**	**136,858**	**1,167,339**	**2,014,314**
Vlera kontabël	**43,009,945**	**498,826**	**1,355,319**	**44,864,090**

				31 Dhjetor 2020
Gama e vonesave	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Totali
Hua dhe paradhënie klientëve				
0-0.18	49,824,618	-	-	49,824,618
0.19-0.66	-	462,049	-	462,049
0.67-1	-	254,940	2,356,994	2,611,934
Totali	**49,824,618**	**716,989**	**2,356,994**	**52,898,601**
Provizionet për humbjen	**480,387**	**229,916**	**1,285,461**	**1,995,764**
Vlera kontabël	**49,344,231**	**487,073**	**1,071,533**	**50,902,837**

				31 Dhjetor 2019
Gama e vonesave	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Totali
Hua dhe paradhënie klientëve				
0-0.18	43,720,062	-	2,048,023	45,768,085
0.19-0.66	-	635,684	1,317	637,001
0.67-1	-	-	473,318	473,318
Totali	**43,720,062**	**635,684**	**2,522,658**	**46,878,404**
Provizionet për humbjen	**710,117**	**136,858**	**1,167,339**	**2,014,314**
Vlera kontabël	**43,009,945**	**498,826**	**1,355,319**	**44,864,090**

7. Administrimi i Riskut Financiar (vazhdim)

(a) Risku i kredisë (vazhdim)

(iii) Cilësia e kredisë sipas kategorive të aktiveve financiare (vazhdim)

* Banka njeh fondin për humbjet nga zhvlerësimi për investimet në letrat me vlerë të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse tek të ardhurat e tjera përmbledhëse

				31 Dhjetor 2020
	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Totali
Hua dhe paradhënie bankave				
Pa probleme	38,062,283	2,529,732	-	40,592,015
Totali	**38,062,283**	**2,529,732**	**-**	**40,592,015**
Provizionet për humbjen	**14,022**	**630**	**-**	**14,652**
Vlera kontabël	**38,048,261**	**2,529,102**	**-**	**40,577,363**
Letra me vlerë të investimit në VDATP				
Pa probleme	36,836,454	734	-	36,837,189
Totali	**36,836,454**	**734**	**-**	**36,837,189**
Provizionet për humbjen	**146,699**	**3**	**-**	**146,702**
Vlera kontabël	**36,689,755**	**731**	**-**	**36,690,487**
Investime në letra me vlerë me kosto të amortizuar				
Pa probleme	31,782,220	3,454,312	-	35,236,532
Totali	**31,782,220**	**3,454,312**	**-**	**35,236,532**
Provizionet për humbjen	**141,584**	**11,731**	**-**	**153,315**
Vlera kontabël	**31,640,636**	**3,442,581**	**-**	**35,083,217**

				31 dhjetor 2019
	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Totali
Hua dhe paradhënie bankave				
Pa probleme	39,204,886	3,288,711	-	42,493,597
Totali	**39,204,886**	**3,288,711**	**-**	**42,493,597**
Provizionet për humbjen	**8,634**	**608**	**-**	**9,242**
Vlera kontabël	**39,196,252**	**3,288,103**	**-**	**42,484,355**
Investime në letra me vlerë me VDATP				
Pa probleme	4,294,799	-	-	4,294,799
Totali	**4,294,799**	**-**	**-**	**4,294,799**
Vlera kontabël	**5,517**	**-**	**-**	**5,517**
Provizionet për humbjen*	**4,289,282**	**-**	**-**	**4,289,282**
Investime në letra me vlerë me kosto të amortizuar				
Pa probleme	60,831,517	2,107,366	-	62,938,883
Totali	**60,831,517**	**2,107,366**	**-**	**62,938,883**
Provizionet për humbjen	**301,928**	**6,594**	**-**	**308,522**
Vlera kontabël	**60,529,589**	**2,100,772**	**-**	**62,630,361**

dhe jo dhe jo si një llogari për vlerën e mbartur të aktivit financiar në pasqyrën e pozicionit financiar (shih shënimin 7 (g) (vii) Paraqitja e fondit për humbjet e pritshme të kredisë në pasqyrën e pozicionit financiar).

** Hua dhe paradhënie bankave përfshijnë llogari rrjedhëse me bankat, depozita në tregun e parasë (shih Shënimin 10) dhe depozita me bankat korrespondente (shih Shënimin 11).

7. Administrimi i Riskut Financiar (vazhdim)

(a) Risku i kredisë (vazhdim)

(iii) Cilësia e kredisë sipas kategorive të aktiveve financiare (vazhdim)

Tabela në vijim paraqet informacion mbi statusin e huave dhe paradhënie klientëve që janë me vonesë në Nivelin 1, 2 dhe 3.

				31 Dhjetor 2020
Hua dhe paradhënie klientëve	**Niveli 1**	**Niveli 2**	**Niveli 3**	**Totali**
Deri në 30 ditë vonesë	49,824,618	341,198	568,750	50,734,566
Më shumë se 30 ditë vonesë	-	375,790	1,788,244	2,164,034
Totali	**49,824,618**	**716,988**	**2,356,994**	**52,898,600**

				31 Dhjetor 2019
Hua dhe paradhënie klientëve	**Niveli 1**	**Niveli 2**	**Niveli 3**	**Totali**
Deri në 30 ditë vonesë	43,720,062	417,094	553,401	44,690,557
Më shumë se 30 ditë vonesë	-	218,590	1,969,257	2,187,847
Totali	**43,720,062**	**635,684**	**2,522,658**	**46,878,404**

Të gjitha huat edhe paradhëniet bankave dhe letrat me vlerë të maturimit, janë klasifikuar nën statusin me vonesë me më pak se 30 ditë vonesë, më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019.

Tabela në vijim paraqet informacion mbi cilësinë e kredisë të letrave me vlerë të borxhit dhe huave dhe paradhënie bankave, në bazë të klasifikimit të agjencisë së vlerësimit Moody, Nivelit dhe kategorisë SNRF:

Letrat me vlerë të investimit të borxhit

Qeveri Qendrore			31 dhjetor 2020
	Niveli 1	**Niveli 2**	**Totali**
Klasifikimi Baa2	**2,885,166**	**1,933,978**	**4,819,144**
VDATP	2,885,166	-	2,885,166
KA	-	1,933,978	1,933,978
Klasifikimi B1	**64,748,634**	**1,509,334**	**66,257,968**
VDATP	33,107,998	731	33,108,729
KA	31,640,636	1,508,603	33,149,239
	67,633,800	**3,443,312**	**71,077,112**

Institucionet financiare

	Niveli 1	**Niveli 2**	**Totali**
Klasifikimi Aaa	**696,592**	-	**696,592**
VDATP	696,592	-	696,592
Totali i Vlerës kontabël	**68,330,392**	**3,443,312**	**71,773,704**

Letrat me vlerë të investimit të borxhit

Qeveri Qendrore			31 dhjetor 2019
	Niveli 1	**Niveli 2**	**Totali**
Klasifikimi Baa2	**2,827,008**	**2,100,772**	**4,927,780**
VDATP	2,827,008	-	2,827,008
KA	-	2,100,772	2,100,772
Klasifikimi B1	**61,251,450**	-	**61,251,450**
VDATP	721,861	-	721,861
KA	60,529,589	-	60,529,589
	64,078,458	**2,100,772**	**66,179,230**

Institucionet financiare

	Niveli 1	**Niveli 2**	**Totali**
Klasifikimi Aaa	**740,413**	-	**740,413**
VDATP	740,413	-	740,413
Totali i Vlerës kontabël	**64,818,871**	**2,100,772**	**66,919,643**

7. Administrimi i Riskut Financiar (vazhdim)

(a) Risku i kredisë (vazhdim)

(iii) Cilësia e kredisë sipas kategorive të aktiveve financiare (vazhdim)

Hua dhe paradhënie bankave

			31 dhjetor 2020
	Niveli 1	Niveli 2	Totali
Klasifikimi Aa1	3,951,970	-	3,951,970
Klasifikimi Aa2	-	-	-
Klasifikimi Aa3	9,931	-	9,931
Klasifikimi A1	33,642	27,427	61,070
Klasifikimi A2	1,583,179	-	1,583,179
Klasifikimi A3	2,383,725	-	2,383,725
Klasifikimi Baa1	18,329,101	2,501,674	20,830,775
Klasifikimi Baa2	27,268	-	27,268
Klasifikimi Baa3	2,961,349	-	2,961,349
Klasifikimi Ba2	5,001,598	-	5,001,598
Klasifikimi Ba3	-	-	-
Klasifikimi B1	-	-	
Klasifikimi B2	-	-	-
Klasifikimi B3	615,373	-	615,373
Klasifikimi CAA	-	-	-
Te pa klasifikuar	3,151,125	-	3,151,125
	38,048,261	2,529,101	40,577,363

			31 dhjetor 2019
	Niveli 1	Niveli 2	Totali
Klasifikimi Aa1	-	-	-
Klasifikimi Aa2	-	-	
Klasifikimi Aa3	13,762	-	13,762
Klasifikimi A1	7,764,149	-	7,764,149
Klasifikimi A2	5,962,337	3,239,897	9,202,234
Klasifikimi A3	-	-	-
Klasifikimi Baa1	-	48,814	48,814
Klasifikimi Baa2	20,891,230	-	20,891,230
Klasifikimi Baa3	2,496,226	-	2,496,226
Klasifikimi Ba3	1,094,419	-	1,094,419
Klasifikimi B1	800,104	-	800,104
Klasifikimi B2	-	-	-
Klasifikimi CAA	182,660	-	182,660
te pa klasifikuar	-	-	-
	39,204,887	3,288,711	42,493,598

7. Administrimi i Riskut Financiar (vazhdim)

(a) Risku i kredisë (vazhdim)

(iv) Kolateralet në zotërim dhe garanci të tjera të kredisë

Fluksi i parashikuar i të ardhurave nga kolateralet dhe/ose garancive që mbulojnë ekspozimet, përbëjnë zakonisht burimin kryesor, të fluksit të të ardhurave në të ardhmen, për linjat e kredisë me probleme. Disa nga parametrat e vlerësimit të përdorura për llogaritje janë:

- *Vlera e realizueshme e kolateraleve*, e cila përllogaritet duke ulur vlerën e tregut të kolateraleve të vlerësuara me një 'faktor skontimi'. Kjo e fundit merr në konsideratë karakteristikat e grupeve të ngjashme të kolateraleve, e cila nënkupton vlerën mesatare të rikuperueshme të një kolaterali të caktuar, bazuar në eksperiencën e Bankës mbi procesin e rikuperimit të kolateraleve.
- *Koha e flukseve të parashikuara të parasë*, e cila i referohet kohës së pritshme të rikuperimit (në vite) të një lloji të caktuar kolaterali.

Kostot e rikuperimit zbriten nga fluksi i ardhshëm i parashikuar i parasë. Kolaterali përgjithësisht nuk mbahet për huatë dhe paradhëniet ndaj institucioneve financiare, përveç kur instrumentet financiare mbahen si pjesë e marrëveshjeve të ndërsjellta dhe aktivitetit të huamarrjes nëpërmjet instrumenteve financiare. Zakonisht, kolaterali nuk mbahet kundrejt instrumenteve të investimit, dhe asnjë kolateral i tillë nuk është mbajtur në 31 dhjetor 2020 dhe 2019. Parashikimet për vlerën e drejtë janë të bazuara në vlerën e kolateraleve, të vlerësuara në momentin e marrjes së borxhit dhe janë gjithashtu të rishikueshme çdo tre vjet. Një përllogaritje e vlerës së drejtë të paskontuar dhe të skontuar të kolateraleve dhe instrumenteve të tjerë garantues, të mbajtur kundrejt aktiveve financiare tregohet më poshtë:

	Kolateralet për huatë dhe paradhëniet klientëve 31 dhjetor 2020		Kolateralet për huatë dhe paradhëniet klientëve 31 dhjetor 2019	
	Bruto	Neto	Bruto	Neto
Ndaj të zhvlerësuarave Individualisht				
Ndërtesa	4,515,057	1,456,225	4,765,766	1,709,133
Letra me vlerë të borxhit	39,700	-	421,236	1,523
Mjete monetare	-	-	193	193
Pengje & Garanci	295,110	-	39,700	-
Të tjera	-	-	-	-
Totali	**4,849,867**	**1,456,225**	**5,226,895**	**1,710,849**
Vlera kontabël Neto		**898,220**		**1,355,319**

Shuma bruto e kolateralit përfshin vlerën e kolateralit përpara testimit të huave individualisht të zhvlerësuara. Shuma neto tregon vlerën e aktualizuar të njëjtit kolateral pas këtij testi. Tabela më poshtë tregon totalin e kolateraleve për huadhëniet e vlerësuara në kategorinë e zhvlerësimit kolektiv, duke përfshirë të gjitha ekspozimet e Nivelit 3 të cilat janë më pak se EUR 100 mijë.

Këto kolaterale nuk kalojnë në të njëjtën procedurë testimi si grupi më sipër. Informacioni në tabelën e mëposhtme tregon se sa janë të siguruara huatë dhe paradhëniet e klientëve të zhvlerësuara kolektivisht ndaj kolateralit përkatës të tyre.

	Kolateralet për huatë dhe paradhëniet klientëve 31 dhjetor 2020		Kolateralet për huatë dhe paradhëniet klientëve 31 dhjetor 2020	
	Bruto	Neto	Bruto	Neto
Ndaj të zhvlerësuarave Kolektivisht				
Ndërtesa	80,879,648	36,155,755	79,525,887	34,465,256
Pengje & Garanci	43,960,488	1,984,816	19,023,744	1,483,977
Mjete monetare	791,352	759,767	1,381,122	1,331,340
Letra me vlerë të borxhit	1,681,404	54,559	2,604,292	42,981
Të tjera	1,092,724	-	1,204,056	-
Totali	**128,405,616**	**38,954,897**	**103,739,101**	**37,323,554**
Vlera kontabël		**44,869,755**		**43,508,771**

7. Administrimi i Riskut Financiar (vazhdim)

(a) Risku i kredisë (vazhdim)

(iv) Kolateralet në zotërim dhe garanci të tjera të kredisë (vazhdim)

Banka ka si politikë të saj shitjen e aktiveve të rimarra në zotërim nëpërmjet procesit të rikuperimit. Vlerat që mblidhen nga të ardhurat e shitjes së aktivit, përdoren për të zvogëluar ose shlyer vlerën e mbartur të huave me probleme.

Tabela në vijim paraqet vlerën kontabël dhe vlerën bruto të kolateralit të huave dhe paradhënieve të klientëve të cilat maten me kosto të amortizuar.

	31 dhjetor 2020		31 dhjetor 2019	
	Vlera kontabël	Kolaterali	Vlera kontabël	Kolaterali
Niveli 1 dhe Niveli 2	49,831,304	128,405,616	44,355,746	102,462,453
Niveli 3	1,071,533	4,849,868	2,522,658	6,503,543
	50,902,837	**133,255,484**	**46,878,404**	**108,965,996**

Në rastin e kolateraleve në pronësi të Bankës, konvertimi në para është qëllimi kryesor i Bankës, e cila ndërmerr një marketing të mirëfilltë për shitjen. Nëse nuk merr asnjë ofertë të mirë deri në një moment të caktuar, Banka ka si procedurë të mbajë aktivin në inventarët e saj për shitje deri sa të marrë ofertën më të mirë. Vlera e aktiveve afatgjata materiale, të rimarra në zotërim, janë paraqitur në shënimin 18. Në varësi të nevojave operacionale të Bankës dhe përshtatshmërisë së aktivit për t'i plotësuar ato nevoja, Drejtimi vendos ta vër atë në përdorim, rrjedhimisht bëhet një riklasifikim në aktivet në përdorim të Bankës (shih shënimin 14).

(v) Shumat që rezultojnë nga Humbjet e Pritshme të Kredisë

Të dhënat, supozimet dhe teknikat që përdoren për të përllogaritur zhvlerësimin

Shih politikën kontabël në Shënimin 6.(f).(vii).

Rritja e konsiderueshme e rrezikut të kredisë

Gjatë përcaktimit nëse rreziku i mospagimit të një instrumenti financiar është rritur ndjeshëm që nga momenti i njohjes fillestare, Banka vlerëson informacion të arsyeshme dhe të besueshme që janë relevante dhe të disponueshme pa kosto ose përpjekje të panevojshme. Kjo përfshin informacione dhe analiza sasiore dhe cilësore, bazuar në tendencën historike të Bankës dhe vlerësimin profesional të kredisë dhe duke përfshirë informacionin e parashikuar. Qëllimi i vlerësimit është të identifikojë nëse për një ekspozim të caktuar ka ndodhur ndonjë rritje e konsiderueshme e rrezikut duke krahasuar:

- probabilitetin e mospagesës (PD) për jetëgjatësinë e mbetur në datën e raportimit; me
- probabilitetin e mospagesës (PD) për jetëgjatësinë e mbetur për këtë moment në kohë që është vlerësuar në njohjen fillestare të ekspozimit (e rregulluar sipas rastit për ndryshime në pritshmëritë e parapagimit).

Banka përdor tre kritere për të përcaktuar nëse ka ndodhur një rritje e konsiderueshme e rrezikut të kredisë:

- testimi sasior në bazë të lëvizjes së probabilitetit të mospagesës, vetëm për hua dhënë bankave dhe letrave me vlerë të investimit;
- tregues cilësor në bazë sinjaleve të devijimit dhe paralajmërimit të hershëm; dhe
- limitin prej 30 ditë vonesë

7. Administrimi i Riskut Financiar (vazhdim)

(a) Risku i kredisë (vazhdim)

(v) Vlerat që rezultojnë nga humbjet e pritshme të kredisë (vazhdim)

Përkufizimi mospërmbushjes së detyrimeve (mospagimi)

Banka vlerëson se një aktiv financiar është subjekt i mospagimit kur:

- huamarrësi është në paaftësi paguese (edhe pse në mënyrë të ligjshme nuk të deklarohen si të tillë) ose de facto janë në një status të ngjashëm. Me "gjendjen e paaftësisë paguese" do të nënkuptohet: paaftësia strukturore dhe e përhershme (jo e përkohshme) për të plotësuar dhe përmbushur, rregullisht dhe përmes burimeve të zakonshme, detyrimet e palës për shkak të mungesës së likuiditetit dhe/ose për të vlerësuar financimin e jashtëm;
- huamarrësi nuk ka mundësi të paguaj detyrimet e tij për ripagimin e kredisë, pa rikurs nga Banka për veprimet që lidhen me garancinë/kolateralin.
- huamarrësi nuk ka kryer pagesën për më shumë se 90 ditë sikundër përshkruhet në shënimin 7(a)(i).

Përfshirja e informacionit të parashikuar

Banka përfshin informacionin e parashikuar në matjen e humbjes së pritshme të kredisë. Banka ka identifikuar dhe dokumentuar faktorët kryesorë të rrezikut të kredisë dhe humbjeve të kredisë për secilin portofol të instrumenteve financiare dhe nëpërmjet analizës së historikut të të dhënave, ka vlerësuar marrëdhëniet midis koeficienteve të stresit të ABE (Autoritetit Bankar Europian) dhe humbjes së kredisë. Banka vlerëson tre skenarë ekonomike: skenarin bazë, skenarin e rënduar, sikundër është publikuar nga ABE, dhe skenarin më të mirë, një vlerësim i brendshëm si pasqyrim simetrik i skenarit të rënduar ndaj skenarit bazë.

Aktivet financiare të modifikuara

Kushtet kontraktuale të një kredie mund të ndryshohen për një numër arsyesh, duke përfshirë ndryshimin e kushteve të tregut, mbajtjen e klientëve dhe faktorë të tjerë që nuk lidhen me përkeqësimin aktual ose potencial të kredisë së klientit. Një hua ekzistuese, kushtet e të cilës janë modifikuar, mund të mos njihet dhe huaja e rinegociuar mund të njihet si një kredi e re me vlerë të drejtë, në përputhje me politikën kontabël të përcaktuar në Shënimin 6 (f)(iv).

Matja e humbjes së pritshme të kredisë (HPK)

Kuadri i ri, SNRF 9 (Standardi Ndërkombëtar i Raportimit Financiar) - Instrumentet Financiare, bazohen në vlerësimin e humbjeve të pritshme, ndryshe nga humbjet që kanë ndodhur sipas SNK 39. Në momentin e njohjes të një përkeqësimi të konsiderueshëm të cilësisë së kredisë, prezantohet koncepti i ri i humbjes gjatë gjithë jetëgjatësisë. Humbja e pritshme gjatë gjithë jetëgjatësisë mbulon të gjithë humbjen e pritshme sipas SNRF 9, i cili specifikon se nëse rreziku i kredisë për një instrument financiar është rritur ndjeshëm, që nga momenti i njohjes fillestare, subjekti duhet të matë zbritjen për zhvlerësimin për instrument financiar përkatës, si një shumë e barabartë me humbjet e pritshme të kredisë gjatë gjithë jetëgjatësisë dhe nëse rreziku i kredisë për këtë instrument nuk është rritur ndjeshëm, atëherë duhet të llogariten humbjet e pritshme 12 mujore.

Humbjet e pritshme të kredisë për ekspozimet në nivelin e parë, llogariten duke shumëzuar probabilitetin e mospagesës (PD) 12 mujor, me humbjen e mundshme nga mospagesa (LGD) dhe ekspozimin e papaguar (EAD). Humbja e pritshme e kredisë gjatë gjithë jetëgjatësisë llogaritet duke shumëzuar probabilitetin e mospagesës gjatë gjithë jetëgjatësisë, me humbjen e mundshme nga mospagesa dhe ekspozimin e papaguar

Banka përdor modele statistikore për të analizuar të dhënat e mbledhura dhe për të gjeneruar vlerësime të probabilitetit të dështimit të pjesës së mbetur të jetëgjatësisë të ekspozimeve dhe se si këto priten të ndryshojnë me kalimin e kohës. Banka mbledh informacione mbi ecurinë dhe mospërmbushjen e detyrimeve për ekspozimet e saj ndaj rrezikut të kredisë të cilat analizohen sipas llojit të produktit dhe huamarrësit si dhe sipas klasifikimit të rrezikut të kredisë. Për disa portofole përdoren edhe informacionet e siguruar nga agjencitë e jashtme të referimit të kredisë.

7. Administrimi i Riskut Financiar (vazhdim)

(a) Risku i kredisë (vazhdim)

(v) Vlerat që rezultojnë nga humbjet e pritshme të kredisë (vazhdim)

Humbja e mundshme nga mospagesa (LGD) është madhësia e humbjes së mundshme në rastin e moskryerjes së pagesës për ripagimin e kredisë. Banka vlerëson parametrat e humbjes së mundshme nga mospagesa (LGD) në bazë të historikut të normave të humbjes nga palët që nuk kanë përmbushur kushtet e pagesës. Modelet e humbjes së mundshme nga mospagesa (LGD) vlerësojnë strukturën, kolateralin, vjetërsinë e kërkesës, industrinë e kundërpalës dhe kostot e rikuperimit të çdo kolaterali që është pjesë përbërëse e aktivit financiar. Për huatë e siguruara me prona të individëve, raporti hua vlerë (LTV) përbën një parametër kryesor në përcaktimin e humbjes së mundshme nga mospagesa (LGD). Vlerësimet e humbjes së mundshme nga mospagesa (LGD) llogariten në bazë të fluksit të mjeteve monetare, të skontuara nëpërmjet normës efektive të interesit si faktori zbritës.

Ekspozimi në mospagesë (EAD) përfaqëson ekspozimin e pritur në rast mospagese. Banka e përcakton ekspozimin në mospagesë (EAD) nga ekspozimi aktual i kundërpalës dhe ndryshimet e mundshme në shumën aktuale të lejuar sipas kontratës dhe që rezultojnë nga amortizimi. Ekspozimi në mospagesë (EAD) i një aktivi financiar është vlera e tij kontabël bruto në kohën e mospagimit. Për angazhimet e huasë, ekspozimet në mospagesë (EAD) janë shuma potenciale në të ardhmen që mund të rezultojnë sipas kontratës, të cilat vlerësohen në bazë të historikut të treguesve të të dhënave dhe parashikimet e ardhshme.

Të dhënat, supozimet dhe teknikat që përdoren për llogaritjen e zhvlerësimit (vazhdim)

Matja e humbjeve të pritshme të kredisë (vazhdim)

Portofoli me risk të ulët mospagese

Për qëllime zhvlerësimi është konsideruar një kategori e re e instrumenteve financiare sipas rregullave të SNRF 9, me emrin "Portofoli me risk të ulët mospagese". Ajo përfshin letrat me vlerë dhe hua dhënë bankave dhe sikundër përcaktohet nga shoqëria mëmë përbëhet nga ekspozimet me palët e mëposhtme.

- Sektorin shtetëror (Bankat qendrore, Qeveritë, Bashkitë, subjektet e Sektorit Publik);
- Institucionet (Bankat dhe institucione të tjera financiare);
  Ekspozimet brenda grupit janë ekspozime me palët e mëposhtme:
- Kompaninë mëmë;
- Filiale të tjera të ISP-së

7. Administrimi i Riskut Financiar (vazhdim)

(a) Risku i kredisë (vazhdim)

(v) Vlerat që rezultojnë nga humbjet e pritshme të kredisë (vazhdim)

Transaksionet brenda grupit përgjithësisht klasifikohen si Niveli 1 me humbje të pritshme 12 mujore, duke ndjekur rregullat e klasifikimit për Portofolin me risk të ulët mospagese dhe ekspozimet brenda grupit në bazë të metodologjive të hartuara nga kompania mëmë, të cilat përfshijnë validimin dhe miratimin. Ekspozimet klasifikohen në Nivelin 2 në bazë të rritjes së ndjeshme të kriterit të rrezikut të kredisë, i cili matet nëpërmjet krahasimit të probabilitetit të mospagesës përgjatë jetëgjatësisë. Ky kriter, për portofolin me risk të ulët mospagese, përcaktohet në bazë të klasifikimit të veçantë specifik dhe maturimit të mbetur të ekspozimit. Pragjet janë përcaktuar nga kompania mëmë.

Kriteri që është përdorur për të vlerësuar nëse cilësia e kredisë së letrave me vlerë të borxhit është përkeqësuar ndjeshëm që nga fillimi, është krahasimi i probabilitetit të mospagesës përgjatë jetëgjatësisë. Klasifikimi i emetuesit të instrumentit (klasifikimi i kundërpalëve) përdoret për krahasimin e probabilitetit të mospagesës gjatë jetëgjatësisë, në vend të klasifikimit të një instrumenti të vetëm (pra, në datën e raportimit, instrumente të ndryshme ose transhe që lidhen me të njëjtin emetues do tu caktohet klasifikimi i kundërpalës në një datë të caktuar). Për letrat me vlerë të borxhit të cilat janë blerë me transhe, probabiliteti i mospagesës në momentin e lëshimit të tyre përcaktohet nëpërmjet metodologjisë FIFO (i pari brenda, i pari jashtë).

Letrat me vlerë të borxhit përfshijnë "Përjashtimin e rrezikut të ulët të kredisë" bazuar në supozimin se rreziku i kredisë nuk është rritur ndjeshëm që nga momenti i njohjes fillestare nëse instrumenti financiar vlerësohet me rrezik të ulët të kredisë në datën e raportimit. Prandaj, instrumentet e investimit në datën e raportimit klasifikohen në Nivelin 1. Ky përjashtim zbatohet vetëm për instrumentet që janë pjesë e portofolit të letrave me vlerë të vendosjes pas kalimit në SNRF 9. Kriteret e mëposhtme janë miratuar për secilën fazë për maturimin e mbetur të obligacioneve të instrumentit financiar.

Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3
• Borxhi pa përkeqësim të ndjeshëm të cilësisë së kredisë • Borxhe investimi	• Borxhi me rritje të ndjeshme të nivelit të probabilitetit të mospagesës që nga fillimi	• Borxh i pakthyeshëm

Për nivelin 3 - Borxhi i pakthyeshëm (dështuar) për të gjitha letrat me vlerë në mënyrë individuale aplikohet procesi i testimit të zhvlerësimit. Nëse vlera e drejtë është më e vogël se vlera kontabël, ose nëse emetuesi nuk plotëson kushtet kontraktuale në lidhje me detyrimet e debitorit ose moskryerjen e pagesave si rezultat i një prej ngjarjeve të mëposhtme:

1. Mospërmbushja e detyrimeve për ripagimin e kredisë;
2. Procedurat e falimentimit;
3. Moskryerja e pagesave të interesit ose principalit.

Nëse ndodh ndonjë nga këto ngjarje, duke pasur parasysh peshën dhe pakthyeshmërinë e situatës së konfirmuar, zbritja nga zhvlerësimi duhet të regjistrohet direkt. Nëse vlera e drejtë nuk është më shumë se 20% më e vogël se vlera kontabël neto dhe nuk ka tregues të tjerë zhvlerësimi, nuk është i nevojshëm testimi i mëtejshëm i letrat me vlerë për zhvlerësim. Testimi i zhvlerësimit për këtë nivel të klasifikimit realizohet sipas rregullave të përcaktuara në Politikën kontabël të Grupit ISP.

Vlerësimi kolektiv dhe vlerësimi individual mbi bazën e portofolit janë qasjet ndaj çmuarjes së zhvlerësimit në bazë të metodave statistikore duke përdorur parametrat e rrezikut të kredisë të cilat vlerësohen bazuar në të dhënat historike për grupet e aktiveve me karakteristika të ngjashme.

7. Administrimi i Riskut Financiar (vazhdim)

(a) Risku i kredisë (vazhdim)

(v) Vlerat që rezultojnë nga humbjet e pritshme të kredisë (vazhdim)

Zbritjet për zhvlerësim

Banka përcakton një fond për humbjet nga zhvlerësimi që prezanton një vlerësim të humbjeve të Komponentët kryesore të kësaj zbritjeje përfshijnë një komponent të humbjes specifike që lidhet me ekspozimet e rëndësishme individuale, si dhe me ekspozimet që zhvlerësohen kolektivisht dhe ekspozimet më pak të rëndësishme dhe një zbritje për humbjet në huatë e vlerësuara kolektivisht, të vendosura për grupe aktivesh me karakteristika të ngjashme në lidhje me humbjet që kane ndodhur por që nuk janë identifikuar.

Tabela e mëposhtme paraqet rakordimin nga gjendja e hapjes deri në gjendjen e mbylljes së fondit, për humbjet nga zhvlerësimi sipas kategorisë së instrumentit financiar.

Lëvizjet në fondin për humbjet nga zhvlerësimi për:

	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Totali
Hua dhe paradhënie bankave				
Gjendja më 1 janar 2020	9,509	6,539	-	16,048
Transferimi në Nivelin 1	-	-	-	-
Transferimi në Nivelin 2	-	-	-	-
Transferimi në Nivelin 3	-	-	-	-
Aktive financiare që nuk janë njohur	(6,488)	-	-	(6,488)
Rimatja e zbritjeve për zhvlerësim, neto	1,155	(5,880)	-	(4,725)
Aktive të reja financiare të gjeneruara ose të blera	4,538	-	-	4,538
Këmbime valutore dhe lëvizje të tjera	(80)	(51)	-	(131)
Gjendja më 31 dhjetor 2020	8,634	608	-	9,242

	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Totali
Hua dhe paradhënie bankave				
Gjendja më 1 janar 2019	62,923	15,202	-	78,125
Transferimi në Nivelin 1	-	-	-	-
Transferimi në Nivelin 2	-	-	-	-
Transferimi në Nivelin 3	-	-	-	-
Aktive financiare që nuk janë njohur	(8,579)	-	-	(8,579)
Rimatja e zbritjeve për zhvlerësim, neto	(50,589)	(12,592)	-	(63,181)
Aktive të reja financiare të gjeneruara ose të blera	6,467	4,306	-	10,773
Këmbime valutore dhe lëvizje të tjera	(713)	(377)	-	(1,090)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	9,509	6,539	-	16,048

7. Administrimi i Riskut Financiar (vazhdim)

(a) Risku i kredisë (vazhdim)

(v) Vlerat që rezultojnë nga humbjet e pritshme të kredisë (vazhdim)

Letra me vlerë të investimit me VDATP	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Totali
Gjendja më 1 janar 2020	**5,517**	-	-	**5,517**
Transferimi në Nivelin 1	-	-	-	-
Transferimi në Nivelin 2	-	-	-	-
Transferimi në Nivelin 3	-	-	-	-
Aktive financiare që nuk janë njohur	(5,517)	-	-	(5,517)
Rimatja e zbritjeve për zhvlerësim, neto	-	-	-	-
Aktive të reja financiare të gjeneruara ose të blera	146,903	3	-	146,906
Këmbime valutore dhe lëvizje të tjera	(204)	-	-	(204)
Gjendja më 31 dhjetor 2020	**146,699**	**3**	**-**	**146,702**

Letra me vlerë të investimit me VDATP	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Totali
Gjendja më 1 janar 2019	**4,629**	-	-	**4,629**
Transferimi në Nivelin 1	-	-	-	-
Transferimi në Nivelin 2	-	-	-	-
Transferimi në Nivelin 3	-	-	-	-
Aktive financiare që nuk janë njohur	(2,077)	-	-	(2,077)
Rimatja e zbritjeve për zhvlerësim, neto	(169)	-	-	(169)
Aktive të reja financiare të gjeneruara ose të blera	3,158	-	-	3,158
Këmbime valutore dhe lëvizje të tjera	(24)	-	-	(24)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	**5,517**	**-**	**-**	**5,517**

Letra me vlerë të investimit me kosto të amortizuar	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Totali
Gjendja më 1 janar 2020	**301,928**	**6,594**	-	**308,522**
Transferimi në Nivelin 1	-	-	-	-
Transferimi në Nivelin 2	-	-	-	-
Transferimi në Nivelin 3	-	-	-	-
Aktive financiare që nuk janë njohur	(301,928)	(6,594)	-	(308,522)
Rimatja e zbritjeve për zhvlerësim, neto	-	-	-	-
Aktive të reja financiare të gjeneruara ose të blera	141,706	12,215		153,921
Këmbime valutore dhe lëvizje të tjera	(122)	(484)	-	(606)
Gjendja më 31 dhjetor 2020	**141,584**	**11,731**	**-**	**153,315**

Letra me vlerë të investimit me kosto të amortizuar	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Totali
Gjendja më 1 janar 2019	**265,837**	**7,801**	-	**273,638**
Transferimi në Nivelin 1	-	-	-	-
Transferimi në Nivelin 2	-	-	-	-
Transferimi në Nivelin 3	-	-	-	-
Aktive financiare që nuk janë njohur	(88,037)		-	(88,037)
Rimatja e zbritjeve për zhvlerësim, neto	(25,823)	(1,266)	-	(27,089)
Aktive të reja financiare të gjeneruara ose të blera	150,137		-	150,137
Këmbime valutore dhe lëvizje të tjera	(186)	59	-	(127)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	**301,928**	**6,594**	**-**	**308,522**

7. Administrimi i Riskut Financiar (vazhdim)

(a) Risku i kredisë (vazhdim)

(v) Vlerat që rezultojnë nga humbjet e pritshme të kredisë (vazhdim)

Hua dhe paradhënie klientëve	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Totali
Gjendja më 1 janar 2020	**710,116**	**136,858**	**1,167,339**	**2,014,313**
Transferimi në Nivelin 1	20,548	(7,784)	(12,764)	-
Transferimi në Nivelin 2	(40,679)	67,512	(26,834)	-
Transferimi në Nivelin 3	(13,385)	(5,856)	19,241	-
Aktive financiare që nuk janë njohur	(155,358)	(10,423)	(51,845)	(217,625)
Rimatja e zbritjeve për zhvlerësim, neto	(121,669)	7,195	111,773	(2,701)
Aktive të reja financiare të gjeneruara ose të blera	68,464	42,180	244,951	355,595
Fshirja e aktiveve	-	-	(166,722)	(166,722)
Këmbime valutore dhe lëvizje të tjera	12,350	234	321	12,905
Gjendja më 31 dhjetor 2020	**480,387**	**229,916**	**1,285,461**	**1,995,764**

	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Totali
Gjendja më 1 janar 2019	**663,165**	**456,354**	**1,452,175**	**2,571,694**
Transferimi në Nivelin 1	(218,731)	77,027	141,704	-
Transferimi në Nivelin 2	3,769	(300,063)	296,294	-
Transferimi në Nivelin 3	451	3,978	(4,429)	-
Aktive financiare që nuk janë njohur	(82,111)	(188,125)	(99,121)	(369,357)
Rimatja e zbritjeve për zhvlerësim, neto	89,053	46,706	15,336	151,095
Aktive të reja financiare të gjeneruara ose të blera	257,528	42,957	90,319	390,804
Fshirja e aktiveve	-	-	(696,935)	(696,935)
Këmbime valutore dhe lëvizje të tjera	(3,008)	(1,976)	(28,004)	(32,988)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	**710,116**	**136,858**	**1,167,339**	**2,014,313**

Tabela e mëposhtme paraqet për vitin 2020 rakordimin midis:

Vlerave të paraqitura në tabelat e mësipërme të cilat rakordojnë gjendjet në hapje dhe mbyllje të zbritjeve për zhvlerësim sipas kategorive të instrumentit financiar;

	Hua dhe paradhëni e bankave	Hua dhe paradhënie klientëve	Letrat me vlerë të investimit me VDATP	Letrat me vlerë të investimit me kosto të amortizuar	Totali
Rimatja e zbritjeve për zhvlerësim, neto	2,138	220,327	5,517	308,522	536,504
Aktive të reja financiare të gjeneruara ose të blera	(6,961)	(355,595)	(146,906)	(153,921)	(663,383)
Gjendja më 31 dhjetor 2020	**(4,823)**	**(135,268)**	**(141,389)**	**154,601**	**(126,879)**

	Hua dhe paradhëni e bankave	Hua dhe paradhënie klientëve	Letrat me vlerë të investimit me VDATP	Letrat me vlerë të investimit me kosto të amortizuar	Totali
Rimatja e zbritjeve për zhvlerësim, neto	11,212	218,262	2,246	115,126	346,846
Aktive të reja financiare të gjeneruara ose të blera	(4,538)	(390,804)	(3,158)	(150,137)	(548,637)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	**6,674**	**(172,542)**	**(912)**	**(35,011)**	**(201,791)**

7. Administrimi i Riskut Financiar (vazhdim)

(a) Risku i kredisë (vazhdim)

(vi) Politikat e fshirjes nga librat kontabël

Banka fshin nga librat një hua (dhe zbritjet për zhvlerësime nga humbje të lidhura me të) kur Këshilli Drejtues i Bankës përcakton se kredia është e paarkëtueshme. Ky vendim arrihet pas marrjes në konsideratë të informacionit për ndodhjen e ndryshimeve të rëndësishme në pozicionin financiar të huamarrësit, në mënyrë të tillë që huamarrësi nuk paguan dot më detyrimet ose kolaterali nuk do të jetë i mjaftueshëm për të shlyer ekspozimin që është subjekt i fshirjes. Politika e Bankës është gjithashtu në përputhje me Rregulloren e ndryshuar nr. 62 "Për Administrimin e Riskut të Kredisë për Bankat dhe Degët e Bankave të Huaja".

7. Administrimi i Riskut Financiar (vazhdim)

(a) Risku i kredisë (vazhdim)

(vii) Përqendrimi i riskut të kredisë

Banka monitoron përqendrimet e riskut të kredisë sipas sektorëve dhe vendit. Analiza e riskut të kredisë në datën e raportimit paraqitet si më poshtë:

	Hua dhe paradhënie klientëve, neto	
Përqendrimi sipas sektorëve	**31 dhjetor 2020**	**31 dhjetor 2019**
Shërbimet	17,690,334	14,994,397
Shitja me shumicë	10,491,366	8,957,759
Ndërtimi	2,177,959	2,464,497
Prodhimi	5,962,678	5,578,467
Pronat e patundshme	379,108	487,818
Të tjera	1,603,084	1,539,817
Korporatat	**38,304,529**	**34,022,755**
Kredi hipotekore	10,141,005	8,521,717
Konsumatore	2,457,303	2,319,618
Individët	**12,598,308**	**10,841,335**
Vlera kontabël	**50,902,837**	**44,864,090**

	Hua dhe paradhënie bankave	
Përqendrimi sipas sektorëve	**31 dhjetor 2020**	**31 dhjetor 2019**
Banka	26,736,572	29,146,303
Vlera kontabël	**26,736,572**	**29,146,303**

	Letra me vlere te investimit	
Përqendrimi sipas sektorëve	**31 dhjetor 2020**	**31 dhjetor 2019**
Qeveri Qendrore	71,077,112	66,179,213
Banka	0	-
Institucione të tjera financiare	696,592	740,430
Vlera kontabël	**71,773,704**	**66,919,643**

Portofoli i riskut të kredisë të Bankës karakterizohet nga përqendrimet e mëposhtme të riskut të kredisë.

	31 dhjetor 2020	Ekspozimi në %	31 dhjetor 2019	Ekspozimi në %
Letrat me vlerë të Republikës së Shqipërisë	66,257,971	36%	58,773,316	34%
Llogaritë me Bankën Qendrore	17,072,920	9%	15,458,575	9%
Totali i riskut direkt të Qeverisë Shqiptare	**83,330,891**	**45%**	**74,231,891**	**43%**
Banka më e madhe	16,025,744	9%	16,564,712	10%
Klienti më i madh	4,592,685	3%	3,256,625	2%
Totali i riskut të bankës më të madhe dhe klientit më të madh	**20,618,429**	**12%**	**19,821,337**	**12%**
Totali i riskut në bilanc	**103,949,320**	**57%**	**94,053,228**	**55%**

Ekspozimi më i madh i bankës është me Grupin dhe klienti më i madh është një Shoqëri private.

7. Administrimi i Riskut Financiar (vazhdim)

(a) Risku i kredisë (vazhdim)

(viii) Risku i shlyerjes

Aktivitetet e Bankës mund të krijojnë risk në kohën e shlyerjes së transaksioneve dhe tregtimit. Risku i shlyerjes është risku i humbjes për shkak të dështimit të një Shoqërie për të shlyer detyrimet për dhënien e parasë në dorë, letrave me vlerë ose aktiveve të tjera sipas marrëveshjes kontraktuale. Risku i shlyerjes me institucione financiare dhe partnere qeveritare përfshihet brenda një sistemi kufizimesh dhe limitesh për të gjitha transaksionet me këta partnere dhe është objekt i monitorimit të përditshëm, sikundër përcaktohet dhe rregullohet në rregulloren e brendshme të ISBAs "Për nivelin e miratimit të Kredisë", në rregulloren e mbi "Limitet e ISBAs për palët Institucione Financiare" dhe në rregulloren e Bankës së Shqipërisë "Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave". Rregullorja e Bankës së Shqipërisë "Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave" u rishikua dhe hyri në fuqi në mars 2015. Në kuadër të miratimit, me qëllim parandalimin e çdo shkelje, të kufijve të kundërpalëve lokale me institucionet financiare të krijuara nga luhatjet e kursit të këmbimit, banka ka integruar kufijtë e nivelit paralajmërues (kufijtë e butë), 23.4% të kapitalit rregullator për ekspozimet ndaj Grupit ISP dhe 18.7% të kapitalit rregullator për ekspozimet ndaj institucioneve/qeverive të tjera financiare, të miratuara nga Komiteti i Rrezikut Financiar më 24 janar 2017 dhe Komiteti i Aktiveve dhe Detyrimeve ka rimiratuar të njëjtin nivel për limitet/kufijtë e butë në 21 mars 2019.

(b) Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit është përcaktuar si paaftësia e mundshme e një institucioni për të plotësuar detyrimet që ka për pagesa për shkak të paaftësisë për të likuiduar aktive ose për të siguruar financim të mjaftueshëm nga tregu (risku i likuiditetit nga financimi), ose për shkak të vështirësive që lidhen me konvertimin e pozicionit të aktiveve financiare që shoqërohen me ndryshime të rëndësishme negative të çmimeve, për shkak të kushteve të papërshtatshme ose çrregullimeve të përkohshme të tregut.

(i) Administrimi i riskut të likuiditetit

Metoda e Bankës për administrimin e likuiditetit është të sigurojë sa më shumë të jetë e mundur, që do të ketë gjithmonë likuiditet të mjaftueshëm për të shlyer detyrimet e saj në kohë, si në kushte normale ashtu edhe në kushte jonormale, pa pësuar humbje të papranueshme ose që rrezikojnë dëmtimin e reputacionit të Bankës. Banka përcakton udhëzimet për administrimin e riskut të likuiditetit dhe një plan emergjence të cilat janë objekt i rishikimit nga strukturat e Grupit, dhe aprovimi nga Komiteti i Riskut Financiar të ISBA dhe Këshilli Drejtues. Departamenti i Thesarit dhe MAP është përgjegjës për administrimin e likuiditetit dhe Divizioni i Administrimit të Riskut është përgjegjës për monitorimin e treguesve dhe verifikimin e zbatimit të limiteve dhe verifikimin e respektimit të limiteve dhe përditësimit vjetor të Rregullores së Bankës për Administrimin e Rrezikut të Likuiditetit. Banka monitoron likuiditetin, në përputhje me këtë rregullore, që të administrojë detyrimet e saj kur duhen realizuar si dhe që të aktivizojë procedura emergjence në rast përshkallëzimi. Një raport i balancuar duhet të ruhet midis burimeve hyrëse dhe fluksit në dalje, si në planin afatshkurtër dhe në atë afatmesëm dhe afatgjatë. Objektivi është organizuar sipas përdorimit të metrikave specifike që vijojnë më poshtë "Raporti i Mbulimit të Likuiditetit afatshkurtër deri në 30 ditë" dhe "Raporti i financimit të qëndrueshëm".

- **Raporti i Mbulimit të Likuiditetit (LCR)** deri në 30 ditë: ka si qëllim të ruaj një nivel të mjaftueshëm të aktiveve të lira likuide me cilësi të lartë (QHLA) për të përmbushur nevojat për likuiditetin afat-shkurtër në rastin e skenarit të stresit të likuiditetit (LCR≥105%).
- **Raporti i Financimit të Qëndrueshëm (NSFR)**: ka si qëllim të garantojë një pozicion të përshtatshëm likuiditeti për një periudhë afat-mesme/afatgjate. Ai përcakton një vlerë minimale të pranueshme financimi, për një periudhë kohore një vjeçare, në lidhje me nevojat që rezultojnë nga karakteristikat e likuiditetit dhe afatet e maturimit të aktiveve dhe ekspozimeve jashtë bilancit (NSFR≥102.5%).

Mbajtja e rezervave të aktiveve likuide (e njohur si "Fondi i Likuiditetit") është një nga mjetet kryesore për zbutjen e riskut të likuiditetit. Për identifikimin dhe matjen e këtij risku, afatmesëm dhe afatgjatë, klasifikimi i aktiveve shumë likuide merr një rëndësi domethënëse.

7. Administrimi i Riskut Financiar (vazhdim)

(b) Risku i likuiditetit (vazhdim)

(i) Administrimi i riskut të likuiditetit (vazhdim)

Në politikën e likuiditetit, Banka ka projektuar një tregues të Raportit të Mbulimit të Likuiditetit (LCR) për një periudhë deri në 3 muaj, duke përfshirë efektin e parashikuar në treg të problemeve akute për likuiditet (në nivel banke) e kombinuar me një krizë të gjerë dhe të përgjithshme tregu, bazuar në supozimet e përcaktuara në udhëzimet e Grupit (LCR deri në 3 muaj ≥90%). Ky tregues ka qenë në fuqi deri në dhjetor 2020, dhe është zëvendësuar nga një tregues i ri "Periudha e mbijetesës" sipas Skenarit Bazë dhe Skenarit të Stresit. Në varësi të kushteve të skenarit të stresit, "Periudha e mbijetesës" duhet të jetë gjithmonë pozitive, të paktën deri në 90 ditë.

Një llogaritje e ngjashme, por jo e njëjtë, përdoret për të vlerësuar përputhshmërinë e Bankës me limitet e likuiditetit të vendosur nga Banka e Shqipërisë, e cila në të gjitha monedhat duhet të jetë mbi 20% për monedhat e huaja dhe mbi 15% për monedhën vendase.

Banka e Shqipërisë ka prezantuar një tregues të ri, Raportin e Mbulimit të Likuiditetit sipas kërkesave të rregullores së Bankës së Shqipërisë (BSH). Limitet dhe kufijtë sipas Raportit të Mbulimit me Likuiditet të Bankës së Shqipërisë që do të hyjnë në fuqi në 1 mars 2020 paraqiten në vijim.

Limiti për totalin e monedhave është vendosur minimalisht 100% dhe për totalin e monedhave të rëndësishme është parashikuar të zbatohen në mënyrë graduale limitet e mëposhtme:

LCR për TOTALIN E MONEDHAVE TË RËNDËSISHME

- 1 mars 2020 50%
- 1 janar 2021 70%
- 1 janar 2022 80%

Në përputhje me kuadrin e tolerancës ndaj rrezikut, banka duhet të përcaktojë limitet e brendshme për Lek dhe çdo monedhë të rëndësishme si (Euro dhe USD). Limitet e LCR në LEK, USD dhe EURO nuk janë vendosur ende në gusht 202 dhe do të jenë në linjë me limitin e LCR për monedhat e huaja, 50% në 2020, 70% në 2021 dhe 80% në 2022.

(ii) Rezerva e detyrueshme

Më 7 shkurt 2018, Banka e Shqipërisë miratoi vendimin nr.14 për ndryshimin e normës së Rezervës së detyrueshme. Këto ndryshime kanë hyrë në fuqi gjatë muajit qershor 2018 deri në gusht 2019 dhe vijojnë si më poshtë:

- Zvogëlimi i normës për rezervën e detyrueshme për detyrimet në monedhë vendase në 7.5% dhe 5% (norma e mëparshme që është aplikuar: 10%).
- Norma e re e rezervës së detyrueshme për detyrimet në monedhë të huaj është 12.5% dhe 20%. Detyrimet në monedhë të huaj deri në 50% të totalit të detyrimeve kanë një normë prej 12.5% dhe për pjesën mbi 50% të totalit të detyrimeve, norma është 20% (norma e mëparshme që është aplikuar: 10%).

Të gjitha raportet e mësipërme të likuiditetit monitorohen periodikisht nga Banka duke iu referuar limiteve të brendshëm dhe udhëzimeve të Grupit si dhe kërkesave të Bankës së Shqipërisë. Gjatë vitit 2020, banka ka respektuar limitet e brendshëm dhe rregullatore.

7. Administrimi i Riskut Financiar (vazhdim)

(b) Risku i likuiditetit (vazhdim)

Tabela paraqitet vetëm për qëllime prezantimi dhe tregon klasifikimin sipas maturimit të mbetur më të hershëm kontraktual të aktiveve dhe detyrimeve financiare. Klasifikimi i portofolit të letrave me vlerë në Nivelin 1 është realizuar në bazë të kritereve të përcaktuara në Politikën e ISBA për Riskun e Likuiditetit. Letrat e tjera me vlerë janë pozicionuar sipas maturitetit të mbetur, duke qenë se konsiderohen si aktive likuide. Koeficientet e sjelljes së Grupit ISP aplikohen për përqindjet e ulura për kategoritë jashtë bilancit si linjat e huave dhe garancive të miratuara. Klasifikimi vlerëson flukset monetare në hyrje dhe dalje nga Banka për aktivet dhe detyrimet financiare në bilanc dhe jashtë bilancit sipas maturimit të mbetur më të hershëm kontraktual dhe nuk reflekton historikun e supozimeve ose ripagimin para afatit. Flukset monetare që priten ndryshojnë nga kjo paraqitje, për shembull llogaria rrjedhëse nga klientët parashikohet të jetë e qëndrueshme ose të rritet.

31 dhjetor 2020	deri në 1 muaj	1-3 muaj	3-12 muaj	1-5 vjet	> 5 vjet	Totali
Aktive (Fluksi i mjeteve monetare hyrëse)	**102,882,562**	**17,322,864**	**16,459,873**	**47,883,656**	**14,497,399**	**199,046,354**
Arka neto	1,503,763	-	-	-	-	1,503,763
Kërkesat minimale për rezervën	-	-	-	16,207,078	-	16,207,078
Paradhënie bankave	14,474,947	-	-	-	-	14,474,947
Letra me vlerë të investimit	62,836,512	-	-	-	-	62,836,512
Letra të tjera me vlerë të investimit	167,730	8,894,176	1,209,094	10,800,086	795,697	21,866,783
Hua Bankave	10,960,420	6,995,150	7,237,197	-	-	25,192,767
Hua dhe paradhënie klientëve (*hua bruto pa probleme*)	12,939,190	1,433,538	8,013,582	20,876,492	13,701,702	56,964,504
31 dhjetor 2020						
Detyrime (Fluksi i mjeteve monetare dalëse)	**(112,500,550)**	**(8,749,685)**	**(22,768,840)**	**(19,199,127)**	**(186,169)**	**(163,404,371)**
Depozita nga bankat dhe klientët - llogari rrjedhëse	(107,338,175)	-	-	-	-	(107,338,175)
Llogari rrjedhëse me bankat	(20,695)	-	-	-	-	(20,695)
Llogari rrjedhëse me klientët	(107,317,480)	-	-	-	-	(107,317,480)
Depozita nga bankat	(1,679,382)	-	-	-	-	(1,679,382)
Depozita nga klientët - Depozita me afat	(3,482,993)	(8,749,685)	(22,768,840)	(19,199,127)	(186,169)	(54,386,814)
Pozicioni neto për zërat e bilancit	**(9,617,988)**	**8,573,179**	**(6,308,967)**	**28,684,529**	**14,311,230**	**35,641,983**
Zëra Jashtë Bilancit (Flukse Monetare Hyrëse)	-	-	-	-	-	-
Zëra Jashtë Bilancit (Flukse Monetare Dalëse)	(332,357)	-	-	-	-	(332,357)
Pozicioni neto për zëra jashtë bilancit	(332,357)	-	-	-	-	(332,357)
Pozicioni neto 31 dhjetor 2020	**(9,950,345)**	**8,573,179**	**(6,308,967)**	**28,684,529**	**14,311,230**	**35,309,626**
Pozicioni neto i akumuluar më 31 dhjetor 2020	**(9,950,345)**	**(1,377,166)**	**(7,686,133)**	**20,998,396**	**35,309,626**	**-**

7. Administrimi i Riskut Financiar (vazhdim)

(b) Risku i likuiditetit (vazhdim)

31 dhjetor 2019	deri në 1 muaj	1-3 muaj	3-12 muaj	1-5 vjet	> 5 vjet	Totali
Aktive (Fluksi i mjeteve monetare hyrëse)	**96,851,459**	**17,207,028**	**17,337,804**	**42,945,476**	**13,194,228**	**187,535,995**
Arka neto	1,444,030	-	-	-	-	1,444,030
Kërkesat minimale për rezervën	-	-	-	15,462,646	-	15,462,646
Paradhënie bankave	15,469,686	-	-	-	-	15,469,686
Letra me vlerë të investimit	58,898,355	-	-	-	-	58,898,355
Letra të tjera me vlerë të investimit	249,589	6,917,706	2,106,637	7,854,245	2,227,022	19,355,199
Hua Bankave	8,358,483	9,046,721	9,624,816	-	-	27,030,020
Hua dhe paradhënie klientëve *(hua bruto pa probleme)*	12,431,316	1,242,601	5,606,351	19,628,585	10,967,206	49,876,059
31 dhjetor 2019						
Detyrime (Fluksi i mjeteve monetare dalëse)	**(100,062,308)**	**(9,548,652)**	**(25,982,861)**	**(19,459,282)**	**(200,977)**	**(155,254,080)**
Depozita nga bankat dhe klientët - llogari rrjedhëse	**(93,661,120)**	-	-	-	-	**(93,661,120)**
Llogari rrjedhëse me bankat	(48,146)	-	-	-	-	(48,146)
Llogari rrjedhëse me klientët	(93,612,974)	-	-	-	-	(93,612,974)
Depozita nga bankat	(2,074,049)	-	-	-	-	(2,074,049)
Depozita nga klientët - Depozita me afat	(4,327,139)	(9,548,652)	(25,982,861)	(19,459,282)	(200,977)	(59,518,911)
Pozicioni neto për zërat e bilancit	**(3,210,849)**	**7,658,376**	**(8,645,057)**	**23,486,194**	**12,993,251**	**32,281,915**
Zëra Jashtë Bilancit (Flukse Monetare Hyrëse)	-	-	-	-	-	-
Zëra Jashtë Bilancit (Flukse Monetare Dalëse)	(281,462)	-	-	-	-	(281,462)
Pozicioni neto për zëra jashtë bilancit	**(281,462)**	-	-	-	-	**(281,462)**
Pozicioni neto 31 dhjetor 2019	**(3,492,311)**	**7,658,376**	**(8,645,057)**	**23,486,194**	**12,993,251**	**32,000,453**
Pozicioni neto i akumuluar më 31 dhjetor 2019	**(3,492,311)**	**4,166,065**	**(4,478,992)**	**19,007,202**	**32,000,453**	-

7. Administrimi i Riskut Financiar (vazhdim)

(b) Risku i likuiditetit (vazhdim)

Informacioni i siguruar lidhet me fluksin e parasë që vjen nga detyrimet financiare jashtë bilancit, kështu që ndryshon konsiderueshëm nga prezantimi në bilanc. Analiza nuk përfshin detyrimet jo financiare dhe kapitalin, dhe përfshin flukset e parasë me interes kontraktual.

Tabela më poshtë tregon detyrimet e kushtëzuara dhe angazhimet financiare të Bankës.

31 dhjetor 2020	1 Muaj	1-3 Muaj	3-12 Muaj	1-5 Vite	>5 Vite	Totali
Angazhime	4,868,368	-	-	-	-	4,868,368
Garanci	5,773,011	-	-	-	-	5,773,011
31 dhjetor 2019						
Angazhime	4,378,023	-	-	-	-	4,378,023
Garanci	5,193,902	-	-	-	-	5,193,902

Banka pret që vetëm një pjesë e vogël e angazhimeve të kërkohet brenda një muaji dhe garancitë të mbyllen sipas afatit të maturimit. (Referojuni dhe shënimit 33 Angazhimet dhe detyrimet e kushtëzuara). Rakordimi ndërmjet tabelës së maturitetit të angazhimeve dhe detyrimeve të kushtëzuara dhe shënimit 33 - Angazhimet dhe Detyrimet e Kushtëzuara është si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Angazhime	**4,868,368**	**4,378,023**
Hua të aprovuara jo të disbursuara	4,868,368	4,378,023
Garanci	**5,773,011**	**5,193,902**
Letër Kredi	1,316,966	948,692
Garanci në favor të klientëve	4,456,045	4,245,210

(c) Risku i Tregut

Risku i tregut është risku që ndryshimet në çmimet e tregut, si norma e interesit, çmimet e kapitalit, kurset e këmbimit të monedhave të huaja, spread-et e kredisë (jo të lidhura me ndryshime të gjendjes së debitorit/kreditorit) do të ndikojnë fitimet e Bankës ose vlerën e mbajtjes së instrumenteve financiare. Objektivi i administrimit të riskut të tregut është të administrojë dhe kontrollojë ekspozimet ndaj riskut të tregut, brenda parametrave të pranueshëm, duke maksimizuar kthimin mbi riskun.

Administrimi i rreziqeve të tregut

Banka mban portofolin e letrave me vlerë në përputhje me SNRF 9 si Letra me vlerë të investimit (HTC) ose letrat me vlerë të vendosjes (HTCS). Portofoli i letrave me vlerë të ISBA administrohet në bazë të "Politikës për Portofolin e ISBAs", e cila përcakton limitet e mëposhtme specifike:

- Sipas ndryshimeve në Politikën e Portofolit Financiar të ISBA-s, e cila u miratua nga Këshilli Drejtues i Bankës në datën 21 prill 2020, banka nuk lejohet të investojë në portofolin e letrave me vlerë të investimit.
- Sipas dispozitës për Raportin e Mjaftueshmërisë së Kapitalit, në datën 01/01/2021, rreziku që i është caktuar letrave me vlerë të emetuara nga Qeveria Shqiptare në monedhë të huaj do të rritet nga 50% në 100%.
- Portofoli i letrave me vlerë duhet të respektojë limitet dhe kufizimet e vendosura në lidhje me llojin e emetuesit që paraqitet në tabelën e mëposhtme.
- Portofoli në tërësinë e vet duhet të respektojë kufizimet e përcaktuara paraprakisht në lidhje me llojin e emetuesit, të cilat klasifikohen në bazë të llojit të emetuesit, klasifikimit dhe monedhës.
- Investimet në letra me vlerë të qeverisë portugeze dhe greke dhe në obligacionet me garanci të këtyre vendeve nuk lejohen.

Për të gjitha investimet në letra me vlerë të borxhit të cilat klasifikohen si letra me vlerë të investimit ose letra me vlerë të vendosjes, të cilat emetohen nga vende që vlerësohen me rrezik sipas Udhëzimeve të ISPs për Riskun e Vendit (p.sh. vende të cilat nuk janë pjesë e Eurozonës dhe me një klasifikim më të vogël se AA-), duhet të ndiqet dhe zbatohet procesi i miratimit dhe procedura e autorizimit të parashikuar në udhëzimet në fuqi.

7. Administrimi i Riskut Financiar (vazhdim)

(c) Risku i Tregut (vazhdim)

Intesa Sanpaolo Bank Albania - Limitet e emetuesit
(Vlerat nominale, Ekuivalenti në mln Euro)

	Lloji i emetuesit	Limit tot. maks. për të gjithë portofolin financiar (Vlera nominale)	Limit tot. maks. sipas Modelit të Biznesit (Vlera nominale)		Limiti maks. i emetuesit të vetëm për të gjithë portofolin financiar (Vlera nominale)
			HTC	HTCS	
i)	Bono Thesari të Qeverisë dhe Obligacione të emetuara nga Qeveria Shqiptare në monedhën vendase.	Asnjë	Asnjë blerje të re	Asnjë	Asnjë
ii)	Letra me vlerë të emetuara nga Qeveria Shqiptare në monedhë të huaj.	Vlera më e ulët midis limitit rregullator[1] dhe 42 mln Euro	Asnjë blerje të re	Vlera më e ulët midis limitit rregullator[1] dhe 42 mln Euro	Vlera më e ulët midis limitit rregullator[1] dhe 42 mln Euro
iii)	-Letra me vlerë të Qeverive të Huaja të emetuara nga vendet G7 (përveç Japonisë), -Letra me vlerë të emetuara nga agjencitë qeveritare ose bankat e zhvillimit me klasifikim Aaa/AAA, -Letrat me vlerë të emetuara nga agjencitë ndërkombëtare me klasifikim Aaa/AAA, të shprehura në monedhat e vendeve anëtare të G7 (përvec JPY) - ku procedura e miratimit të kredisë zbatohet për letrat me vlerë jo-qeveritare.	Asnjë	Asnjë blerje të re	Asnjë	100
iv)	Letrat me vlerë të qeverive të huaja - të emetuara nga vende të BE nuk përfshihen në pikën iii) dhe klasifikohen minimumi A3/A-, të shprehura në monedhat e vendeve anëtare të G7 (përveç-JPY).	50	0	50	15
v)	Obligacionet e garantuara: - të emetuara nga institucionet Financiare me kusht që obligacioni i garantuar të klasifikohet minimumi Aa3/AA-, - të emetuara nga institucionet Financiare në vendin e Kompanisë Mëmë, ku klasifikimi i emetuesit nuk është nën nivelin e klasifikimit të vendit, - të shprehura në monedhën e vendeve anëtare G7, (përveç JPY), për të cilat ndiqet procedura e miratimit të kredisë.	60	0	60	10[2]

7. Administrimi i Riskut Financiar (vazhdim)

(c) Risku i Tregut (vazhdim)

(i) Ekspozimi ndaj riskut të kursit të këmbimit

Risku i kursit të këmbimit përkufizohet si mundësia që luhatjet e kurseve të këmbimit të prodhojnë ndryshime të rëndësishme, si pozitive dhe negative, në pasqyrën e pozicionit financiar të Bankës. Burimet më të rëndësishme të riskut të normës së këmbimit konsistojnë në:

- Huadhëniet dhe depozitat në monedhë të huaj të korporatave dhe individëve;
- Investime në letrat me vlerë në monedhë të huaj;
- Tregtimi i kartëmonedhave të huaja;
- Arkëtimi ose pagesa e interesit, komisioneve, kostove administrative, etj. në monedha të huaja

Ekspozimi i Bankës ndaj riskut të kursit të këmbimit monitorohet çdo ditë nga Departamenti i Riskut të Tregut dhe Operacional që siguron përputhshmëri me limitet e brendshme dhe rregullative. Rregulloret e brendshme caktojnë kufizime për çdo pozicion të hapur valutor, për pozicione të hapura globale, për humbje maksimale dhe Vlerën me Risk ("VaR").

Gjate vitit 2020 ka patur disa shkelje të limitit të kufizimit të humbjeve dhe limitit të Vlerës me Risk, si rezultat i reagimit të parë në treg për shkak të situatës së pandemisë COVID 19 (ndaj vlerësimit të papritur dhe të madh të monedhës së Euros ndaj Lekut gjatë ditëve të fundit, një ndryshim nga 125.40 në 131.06 në datën 30 mars 2020).

Për këtë arsye, limitet e vlerës me risk u rishikuan dhe u rritën nga 4.5 mln në 7 mln LEK dhe limiti për kufizimin e humbjeve u rrit nga 3 mln në 3.5 mln LEK, të cilat u miratuan përkatësisht nga Këshilli Drejtues në datën 30 qershor 2020.

Për konfirmimin/përcaktimin e limiteve të sipërpërmendura është kryer një analizë e detajuar e historikut të të dhënave për një periudhë një vjeçare. Kufizimet rregullative lokale i referohen një limiti maksimal prej 20 % të kapitalit rregullator për çdo pozicion të hapur valutor dhe 30% për pozicionin e përgjithshëm valutor.

Banka ka ruajtur limitet gjatë vitit 2020 në përputhje me rregulloren e Bankës së Shqipërisë.

Aktivet financiare në monedha të huaja janë të paraqitura në çdo shënim respektiv të pasqyrave financiare.

(në mijë Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

7. Administrimi i Riskut Financiar (vazhdim)

(c) Risku i tregut (vazhdim)

(i) Ekspozimi ndaj riskut të këmbimit valutor (vazhdim)

	LEK	USD	EUR	OTHER	TOTAL
Aktive					
Mjete monetare dhe të ngjashme	2,963,586	4,613,545	21,845,880	2,994,339	32,417,350
Hua dhe paradhënie bankave	4,125,170	1,418,991	21,192,258	153	26,736,572
Letra me vlerë të investimit me VDATP	30,491,018	504,341	5,695,128	-	36,690,487
Letra me vlerë të investimit me kosto të amortizuar	31,516,092	1,933,978	1,633,147	-	35,083,217
Hua dhe paradhënie klientëve	17,378,638	2,657,818	30,866,271	110	50,902,837
Ndërtesa dhe pajisje	1,915,582	-	-	-	1,915,582
E drejta për përdorim	601,159	-	-	-	601,159
Aktive afatgjata jo-materiale	489,831	-	-	-	489,831
Aktivet materiale afatgjata të investuara	533,798	-	-	-	533,798
Të drejta tatimore të shtyra	458,319	-	-	-	458,319
Të drejta tatimore afatshkurtra	379,233	-	-	-	379,233
Aktive afatgjata që mbahen për tu shitur	-	-	-	-	-
Aktive të tjera	457,910	22,151	1,938,256	6,771	2,425,088
Aktive gjithsej (1)	**91,310,336**	**11,150,824**	**83,170,940**	**3,001,373**	**188,633,473**
Detyrimet					
Detyrime ndaj bankave	1,944,770	-	316,283	12,373	2,273,426
Detyrime ndaj klientëve	63,770,143	11,052,040	81,700,841	2,984,071	159,507,095
Provizione	457,977	31,096	346,232	-	835,305
Detyrime qiraje	4,741	-	598,245	-	602,986
Detyrime të tjera	1,850,820	26,306	223,691	2,730	2,103,547
Detyrimet tatimore të shtyra	259,345	-	-	-	259,345
Kapitali neto	22,991,983	(582)	60,368	-	23,051,769
Detyrime gjithsej (2)	**91,279,779**	**11,108,860**	**83,245,660**	**2,999,174**	**188,633,473**
Pozicioni valutor neto jashtë bilancit me 31 dhjetor 2020 (1)-(2)	30,557	41,964	(74,720)	2,199	-
Aktive jashtë bilancit	16,088,144	3,471,474	130,015,985	123,155	149,698,758
Detyrime jashtë bilancit	16,193,803	3,506,857	129,998,098	-	149,698,758
Pozicioni valutor neto jashtë bilancit më 31 dhjetor 2020	**(105,659)**	**(35,383)**	**17,887**	**123,155**	-
Totali i pozicionit valutor neto më 31 dhjetor 2020	**(75,102)**	**6,581**	**(56,833)**	**125,354**	-
Aktivet në bilanc më 31 dhjetor 2019	84,330,546	10,029,357	80,847,497	2,364,877	177,572,277
Detyrimet në bilanc dhe kapitali më 31 dhjetor 2019	83,493,058	9,921,700	81,807,475	2,350,044	177,572,277
Pozicioni valutor neto jashtë bilancit më 31 dhjetor 2019	**(243,535)**	**(90,119)**	**333,654**	-	-
Totali i pozicionit valutor neto më 31 dhjetor 2019	**593,953**	**17,538**	**(626,324)**	**14,833**	-

7. Administrimi i Riskut Financiar (vazhdim)

(c) Risku i tregut (vazhdim)

(ii) Ekspozimi ndaj riskut të normës së interesit

Risku kryesor i normës se interesit ndaj të cilit janë të ekspozuar portofolet e Bankës është risku i humbjes nga luhatjet e flukseve të ardhshme të parasë ose vlerave të drejta të instrumenteve financiare për shkak të një ndryshimi në normat e interesave të tregut. Risku krijohet fillimisht nga portofoli i letrave me vlerë, si edhe aktiviteti bankar i lidhur me korporatat dhe individët. Risku i normave të interesit administrohet kryesisht nëpërmjet monitorimit periodik të diferencave e shumave të normave të interesit midis aktiveve dhe detyrimeve të Bankës, si dhe duke përgatitur skenarë analizash mbi normat e interesit për qëllime vendimmarrjeje.

Metoda e përdorur për llogaritjen e riskut të normës së interesit, në aktivet dhe detyrimet e Bankës, është analiza e zhvendosjes së ndjeshmërisë. Kjo matje e miratuar nga Banka duhet të sigurojë që profili i riskut të mund të shqyrtohet nga dy këndvështrime plotësuese të njëra tjetrës:

- perspektiva e vlerës ekonomike (VEK - Vlera Ekonomike e Kapitalit), që vlerëson ndikimin e lëvizjeve të pafavorshme të normave të interesit (dhe luhatjeve të tyre) në vlerën aktuale të flukseve monetare të ardhshme;
- perspektiva e të ardhurave neto nga interesi (NII - Të ardhura nga interesi neto) vlerëson ndikimin e lëvizjeve të pafavorshme të normave të interesit (dhe luhatjeve të tyre) në të ardhurat neto nga interesi.

Aktivet financiare të Bankës dhe detyrimet e saj kanë normë të ndryshueshme interesi ose kanë një datë riçmimi në më pak se një vit, me përjashtim të disa letrave me vlerë shqiptare dhe investimeve në letra me vlerë jo shqiptare, të cilat kanë një norme kuponi midis 0.3 - 6.9% për letrat me vlerë në USD (2019: 2 - 6.9%), dhe nga 0.3 - 3.6% për letrat me vlerë në EURO (2019: 0.3 - 5.8%).

Rregullorja e Bankës për Menaxhimin e Riskut të Interesit, "Udhëzimet e ISBA mbi qeverisjen e IRRBB" dhe "Rregullorja e ISBAs për matjen dhe kontrollin e IRRBB", janë miratuar nga Këshilli Drejtues i ISBAs më 28 korrik 2020.

Këto dokumente zbatojnë dispozitat e fundit rregullatore, të përcaktuara në Udhëzimet e nxjerra nga Kompania Mëmë në janar 2019, bazuar në rregulloren e Autoriteti Bankar Europian (ABE) (ABE/GL/2018/02) dhe zbatimin e dispozitave të udhëzimit të Bankës së Shqipërisë "Për administrimin e rrezikut të normës së interesit në librat e bankës", miratuar sipas vendimit nr.33, datë 30 prill 2013. Rreziku i normës së interesit i gjeneruar nga aktivet dhe detyrimet e Bankës, të matura nëpërmjet analizës së zhvendosjes së ndjeshmërisë së vlerës së drejtë prej ± 100 pikësh bazë, të regjistruara në fund të dhjetorit 2020, vlerësohet me -732 milionë Lek (për + 100 pikë bazë) krahasuar me fundin e vitit 2019 -619 milionë Lek.

7. Administrimi i Riskut Financiar (vazhdim)

(c) Risku i tregut (vazhdim)

(ii) Ekspozimi ndaj riskut të normës së interesit (vazhdim)

Tabela më poshtë tregon ndarjen sipas monedhave të analizës së zhvendosjes së ndjeshmërisë për fundin e vitit 2020 dhe 2019.

Zhvendosja e ndjeshmërisë 31-dhjetor-20	Rritje në pikë bazë	Totali	Ndjeshmëria e Fitimit & Humbjes	Ndjeshmëria e Kapitalit
EUR	+100 b.p. / -100 b.p.	(341,674)/152,055	(293,238)/134,943	(48,036)/17,112
USD	+100 b.p. / -100 b.p.	(82,404)/90,163	(80,201)/87,930	(2,203)/2,234
LEK	+100 b.p. / -100 b.p.	(309,602)/311,968	(25,205)/54,590	(284,397)/257,378
Të tjera (GBP & CHF)	+100 b.p. / -100 b.p.	891/(959)	891/(959)	0/0

Zhvendosja e ndjeshmërisë 31-dhjetor-19	Rritje në pikë bazë	Totali	Ndjeshmëria e Fitimit & Humbjes	Ndjeshmëria e Kapitalit
EUR	+100 b.p. / -100 b.p.	(214,693)/(143,471)	(206,040)/138,733	(8,654)/4,738
USD	+100 b.p. / -100 b.p.	(99,150)/(108,806)	(96,935)/106,652	(2,215)/2,155
LEK	+100 b.p. / -100 b.p.	(307,181)/307,609	(290,312)/291,657	(16,869)/15,952
Të tjera (GBP & CHF)	+100 b.p. / -100 b.p.	1,763/(1,804)	1,763/(1,804)	0/0

Kufizimet në analizën e zhvendosjes së ndjeshmërisë për vlerën e drejtë për një goditje prej + 100bp dhe ndjeshmëria NII për goditjet +/- 50bp janë përfshirë tek limitet e RAF për ISBA 2020.

Analiza e zhvendosjes së ndjeshmërisë të të ardhurave neto nga interesi regjistron efektet NII të cilat rezultojnë nga lëvizja e normave të tregut në momentin e rinovimit / ri-çmimit të librit të bankës. Ajo saktëson ndikimin afat-shkurtër në të ardhurat neto nga interesi, ndaj një goditje paralele të menjëhershme dhe të përhershme prej +/- 50 pikë të kurbës së normës së interesit. Kjo masë evidenton efektin e ndryshimeve në normat e tregut në marzhin e interesit i cili gjenerohet nga portofoli që matet, duke përjashtuar efektet e mundshme që rezultojnë nga operacionet e reja dhe ndryshimet në të ardhme të grupit të aktiveve dhe detyrimeve. Kohëzgjatja e referencës zakonisht kufizohet në një vit dhe sipas hipotezës që institucioni është në gjendje të vazhdojë aktivitetet e tij ("parimi i vazhdimësisë").

Risku i normës së interesit gjeneruar nga aktivet dhe detyrimet e Bankës dhe i matur nëpërmjet analizës së ndjeshmërisë sipas zhvendosjes ± 50 pikesh, regjistroi në 31 dhjetor 2020 një vlerë prej 270 milion Lek (për +50 pikë) dhe një vlerë prej -304 milion Lek (për -50 pikë), në krahasim me vlerën prej 258 milion Lek (për +50 pikë) dhe vlerën prej -260 milion lek (për -50 pikë) në dhjetor 2019.

Një model i sjelljes paraqitet për qëllimet e ndjeshmërisë së NII, i cili zbatohet për pozicionet e klientëve në lek dhe euro, duke përcaktuar normën e interesit të klientit në afat të gjatë dhe duke përfshirë tiparet e sjelljes dhe reagimin e vonuar ndaj normave të interesit të tregut (në afatshkurtër) që rezulton nga modeli. Modeli i sjelljes është krijuar nga Departamenti i Zyrës Qendrore të Risqeve Financiare dhe Tregut të ISP, bazuar në të dhënat historike të ISBA të përftuara nga struktura lokale e rrezikut.

Banka Qendrore i kërkoi Bankës të përdorë një metodë tjetër për të matur riskun e normës së interesit, e cila konsiston në një monitorim tremujor të ekspozimit të riskut të normës së interesit ndaj një goditje paralele prej +/- 200 pikë bazë të kurbës së normës së interesit. Për të gjitha kategoritë financiare të aktiveve dhe pasiveve të ndara sipas një normë fikse ose të luhatshme, vlera e tyre aktuale është llogaritur dhe klasifikuar në 14 shporta kohore. Më pas vlera aktuale totale shumëzohet përkatësisht me kohëzgjatjen e vlerësuar të modifikuar të çdo shporte kohore. Limiti për këtë ekspozim është 20% i kapitalit rregullator të Bankës. Për vitin 2020, Banka ka qenë brenda limitit ku ekspozimi ndaj riskut të normës së interesit më 31 dhjetor 2020 rezultoi 10.0% të kapitalit rregullator të Bankës (31 dhjetor 2019: 7.9%).

Banka ka qenë brenda kufijve në përputhje me rregulloren e Bankës së Shqipërisë dhe rregulloren e brendshme gjatë vitit 2020.

7. Administrimi i Riskut Financiar (vazhdim)

(c) Risku i tregut (vazhdim)

(ii) Ekspozimi ndaj riskut të normës së interesit)

Tabelat e mëposhtme paraqesin në mënyrë të përmbledhur aktivet dhe detyrimet e Bankës ndaj riskut të normave të interesit fikse dhe të ndryshueshme, siç raportohet në Kompaninë Mëmë dhe në drejtimin e Bankës. Informacioni nuk është i njëjtë me atë të dhënë nga drejtimi por është rregulluar sipas tabelës më poshtë.Bazuar në drejtimin e rregullores së riskut të normave të interesit, secili instrument financiar vendoset në hendekun e rivlerësimit bazuar në flukse monetare kontraktuale të paskontuara ose në datën e riçmimit. Kontratat përfshijnë instrumente ku Banka përcakton saktësisht kur bëhet maturimi ose riçmimi i ardhshëm.

31 dhjetor 2020		Pa afat	0-3 muaj	3-18 muaj	18m - 3 vite	3 - 5 vite	>5 vite	Totali
Aktive	**Lloji i normave të interesit**							
Hua dhe paradhënie bankave	Fikse	17,314,251	33,088,722	7,237,197	-	-	-	57,640,170
	Të ndryshueshme	-	-	-	-	-	-	-
Hua dhe paradhënie klientëve	Fikse	11,491,088	947,276	5,060,632	2,476,423	1,304,973	1,412,930	22,693,322
	Të ndryshueshme	1,237,287	4,234,608	24,137,760	360,812	318,346	495,151	30,783,964
Investime në letra me vlerë	Fikse	-	11,343,991	37,711,095	11,335,030	8,483,676	2,142,990	71,016,782
	Të ndryshueshme	-	3,552,167	513,347	11,649	692	-	4,077,855
Hua me probleme	Fikse	(117,858)	323,448	560,263	32,006	62,178	154,576	1,014,613
Aktive të tjera financiare	Të ndryshueshme	1,503,763	-	-	-	-	-	1,503,763
Aktive financiare gjithsej (me interes)		**31,428,531**	**53,490,212**	**75,220,294**	**14,215,920**	**10,169,865**	**4,205,647**	**188,730,469**
Detyrimet								
Detyrime ndaj bankave	Fikse	(596,923)	(1,362,000)	-	-	(317,333)	-	(2,276,256)
	Të ndryshueshme	-	-	-	-	-	-	-
Detyrime ndaj klientëve	Fikse	(107,332,135)	(11,622,982)	(25,860,053)	(10,548,007)	(5,539,387)	(188,288)	(161,090,852)
	Të ndryshueshme	-	-	-	-	-	-	-
Detyrime financiare gjithsej (me interes)	Fikse	(490,149)	(36,473)	(283,989)	(128,761)	(90,347)	(39,456)	(1,069,175)
	Të ndryshueshme	-	-	-	-	-	-	-
Detyrime financiare gjithsej (me interes)		**(108,419,207)**	**(13,021,455)**	**(26,144,042)**	**(10,676,768)**	**(5,947,067)**	**(227,744)**	**(164,436,283)**
Pozicioni neto i ndjeshmërisë së interesit		**(76,990,676)**	**40,468,757**	**49,076,252**	**3,539,152**	**4,222,798**	**3,977,903**	**24,294,186**

Sjellja përfshin instrumente që nuk janë të përshtatshme, që jeta e mbetur dhe/ose norma e interesit e të cilave kanë nivele të larta të pasigurisë që mund të ndikohen nga sjelljet specifike të klientëve, si huatë (paradhëniet ndaj bankave dhe paradhëniet ndaj klientëve) dhe depozitat me afat (llogaritë rrjedhëse për klientët) janë pozicionuar në kategorinë pa afat, deri në përcaktimin e koeficienteve të sjelljes. Pozicioni neto i ndjeshmërisë së interesit llogaritet sipas rregullave të brendshme mbi rrezikun e normës së interesit dhe si diferencë midis aktiveve që mbartin interesa dhe detyrimeve që mbartin interes në një klasifikim kohor të dhënë. Aktivet/detyrimet e tjera financiare, kapitali dhe rezervat, janë zëra që nuk përfshihen në pozicionin neto të ndjeshmërisë së interesit duke mos u konsideruar si zëra që mbartin interesa.

7. Administrimi i Riskut Financiar (vazhdim)

(c) Risku i tregut (vazhdim)

(ii) Ekspozimi ndaj riskut të normës së interesit (vazhdim)

31 dhjetor 2019	Lloji i normave të interesit	Pa afat	0-3 muaj	3-18 muaj	18m - 3 vite	3 - 5 vite	>5 vite	Totali
Aktive								
Hua dhe paradhënie bankave	Fikse	15,477,295	32,865,605	9,624,816	-	-	-	57,967,716
	Të ndryshueshme	-	-	-	-	-	-	-
Hua dhe paradhënie klientëve	Fikse	12,360,484	773,965	4,727,470	2,588,225	1,285,437	1,097,731	22,833,312
	Të ndryshueshme	74,407	5,694,239	20,070,008	625,210	488,603	567,739	27,520,206
Investime në letra me vlerë	Fikse	146,340	6,667,894	31,562,700	13,920,677	8,644,785	5,056,626	65,999,022
	Të ndryshueshme	-	2,609,430	3,046,786	30,826	24,517	-	5,711,559
Aktive të tjera financiare	Fikse	-	-	-	-	-	-	-
	Të ndryshueshme	-	-	-	-	-	-	-
Aktive financiare gjithsej (me interes)		**28,058,526**	**48,611,133**	**69,031,780**	**17,164,938**	**10,443,342**	**6,722,096**	**180,031,815**
Detyrimet								
Detyrime ndaj bankave	Fikse	(193,861)	(1,690,188)	(71,417)	-	(312,444)	-	(2,267,910)
	Të ndryshueshme	-	-	-	-	-	-	-
Detyrime ndaj klientëve	Fikse	(93,764,582)	(13,578,466)	(28,441,551)	(6,073,294)	(10,927,298)	(200,977)	(152,986,168)
	Të ndryshueshme	-	-	-	-	-	-	-
Detyrime të tjera	Fikse	-	-	-	-	-	-	-
	Të ndryshueshme	-	-	-	-	-	-	-
Detyrime financiare gjithsej (me interes)		**(93,958,443)**	**(15,268,654)**	**(28,512,968)**	**(6,073,294)**	**(11,239,742)**	**(200,977)**	**(155,254,078)**
Pozicioni neto i ndjeshmërisë së interesit		**(65,899,917)**	**33,342,479**	**40,518,812**	**11,091,644**	**(796,400)**	**6,521,119**	**24,777,737**

7. Administrimi i Riskut Financiar (vazhdim)

(d) Risku operacional

Risku operacional përkufizohet si rreziku i humbjes që rezulton nga procese të brendshme të papërshtatshme ose jo funksionale, mos-veprimi ose veprimi i papërshtatshëm i punonjësve, mos-funksionimi i sistemeve ose ngjarje të jashtme. Ky përkufizim përfshin rrezikun ligjor, ose rrezikun e humbjeve që rezulton nga shkelja dhe mos-repspektimi i ligjit ose rregulloreve, nga detyrimet kontraktuale ose konstruktive ose nga mosmarrëveshje të tjera; rrezikun e modelit, i cili përkufizohet si humbja e mundshme që pëson një subjekt, si rezultat i vendimeve të cilat bazohen kryesisht në rezultatet e modeleve të brendshme, që janë shkaktuar gjatë zhvillimit, implementimit ose përdorimit të tyre; rrezikun e përputhshmërisë rregullative, i cili përkufizohet si rreziku për të qenë subjekt i penaliteteve gjyqësore ose administrative, humbjet financiare të konsiderueshme të cilat rezultojnë nga shkelja e rregulloreve të detyrueshme ose rregullave të vetë bankës; rrezikun TIK (Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit, ose thjesht rreziku kompjuterik) i cili përkufizohet si risku për të pësuar humbje ekonomike në lidhje me përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Rreziku strategjik dhe reputacional nuk janë përfshirë.

Këshilli Drejtuesi i Bankës ka miratuar udhëzimet e kuadrit të përgjithshëm për administrimin e riskut operacional së bashku me politikën dhe procesin organizativ për matjen, administrimin dhe kontrollin e riskut operacional. Rregullorja e Bankës mbi Udhëzimet për Administrimin e Riskut Operacional është në përputhje të plotë me Udhëzimet e Grupit për Administrimin e Riskut Operacional, miratuar në dhjetor 2014.

Komiteti i Administrimit të Riskut Operacional të Bankës (këtu dhe më poshtë referuar ORCO) është përgjegjëse administrimin e riskut operacional të bankës në lidhje me rishikimin e dokumentacionit të administrimit të riskut operacional dhe miratimit të ndryshimeve, përgatitjes së politikave, standardeve dhe metodologjive për administrimin e riskut operacional. Një nga instrumentet që aplikohet për administrimin e riskut operacional është përcaktimi i Treguesve Kryesor të Riskut Operacional (KRI). Në tetor 2015 Komiteti i Riskut Operacional të ISBA-s miratoi listën përfundimtare të Treguesve Kryesor të Riskut dhe limitet. Nga momenti i miratimit të tyre, Treguesit Kryesor të Brendshëm janë monitoruar dhe raportuar çdo tremujor në mbledhjet e Komitetit të Riskut Operacional dhe Këshillit Drejtues. Treguesit e brendshëm KRI rishikohen çdo vit për të siguruar pajtueshmërinë e tyre me dinamikën e kuadrit operacional dhe rreziqet e rëndësishme me të cilat përballet Banka. Çdo ndryshim në politikën për Treguesit Kryesor të Riskut miratohet në Komitetin e Riskut Operacional dhe Këshillin Drejtues.

Limitet për KRI të Bankës së Shqipërisë janë përcaktuar dhe integruar në "Politikën e ISBAs për Treguesit Kryesor të Riskut", miratuar në mbledhjen e Këshillit Drejtues, datë 4 maj 2018. KRI-të monitorohen çdo tremujor sipas rregullores së Bankës së Shqipërisë "Për administrimin e Riskut operacionale" në fuqi, dhe raportohen në mbledhjet e Komitetit të Administrimit të Riskut Operacional dhe Këshillit Drejtues.

Divizioni i Administrimit të Riskut të Kredisë është përgjegjës për identifikimin, vlerësimin, administrimin dhe zbutjen e rreziqeve operacionale, verifikimin e efikasitetit të zbutjes si dhe për raportimin tek Drejtimi i Lartë i Bankës dhe Administrimin e Riskut të Grupit me qëllimin për të vlerësuar ndikimin e mundshëm ekonomik të ngjarjeve operacionale veçanërisht të rënda.

Banka realizon një fushatë vlerësimi vjetor të projektuar nga Grupi Intesa Sanpaolo dhe procesin e vetë-vlerësimit, të cilat kanë në fokus identifikimin dhe vlerësimin e riskut operacional që lidhet me aktivitetin e çdo njësie të vetme brenda një strukture.

Objektivat e procesit të vetë-vlerësimit janë të identifikojnë, masë, monitorojë dhe të zbusë rreziqet operacionale. Procesi i vetë-vlerësimit kontribuon në përhapjen e kulturës së kontrollit të riskut në Bankë. Ky proces përbëhet nga faza të caktuara të cilat lidhen me vlerësimin e mjedisit të biznesit, që përcakton cilësinë e profilit të kontrollit të riskut të çdo strukture nëpërmjet analizës së rëndësisë dhe nivelit të administrimin e faktorëve të riskut në kontekstin dhe fazat operacionale në lidhje me analizën e skenarit, e cila përcakton madhësinë e profilit të riskut të çdo strukture duke mbledhur të dhënat sasiore të përllogaritura nga Njësitë Përgjegjëse të Biznesit dhe Operacionale.

Në bazë të rregullores për administrimin e riskut operacional, e cila ka hyrë në fuqi në janar 2011, Banka ka të njëjtat përgjegjësi ndaj Bankës së Shqipërisë. Banka raporton rregullisht për treguesit kryesorë dhe klasifikimin e humbjeve operacionale efektive, sipas linjave të biznesit bazuar mbi kërkesat rregullatore.

7. Administrimi i Riskut Financiar (vazhdim)

(e) Menaxhimi i kapitalit

Rregullatori kryesor i Bankës, Banka Qendrore, vendos dhe monitoron kërkesën për kapital të Bankës. Politika e Bankës është të mbaje bazën e kapitalit brenda limiteve, duke kapitalizuar të gjitha të ardhurat nga aktiviteti në mënyrë që të mbështesë zhvillimin e ardhshëm të biznesit duke njohur impaktin aktual të nivelit të kapitalit mbi kthimet ndaj aksionereve. Banka njeh nevojën për të mbajtur një ekuilibër midis kthimeve me të larta që mund të jenë të mundura duke përdorur me shume instrumente dhe avantazhe që ofrohen nga një pozicion i fortë i kapitalit.

Nëpërmjet zbatimit të kërkesave aktuale për kapitalin, Banka e Shqipërisë i kërkon Bankës të ruaj raportin e vendosur të kërkesave aktuale për kapital ndaj totalit të aktiveve të ponderuara me risk dhe zërave jashtë bilancit në nivelin minimal të 12%. Gjatë vitit ushtrimor 2020, raporti i mjaftueshmërisë së Bankës rezultoi mbi nivelin minimal të kërkuar, i cili më 31 dhjetor 2020 rezulton 21.54% (2019: 22.69%).

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit i ndryshuar, i cili përfaqëson raportin e kapitalit bazë ndaj aktiveve të ponderuara me risk dhe zërat jashtë bilancit, është një limit tjetër prej 6% që ka vendosur Banka e Shqipërisë. Gjatë gjithë periudhës nuk kanë rezultuar ndryshime materiale në administrimin e kapitalit të bankës dhe janë respektuar të gjitha kërkesat rregullatore për kapital.

Rregullorja e re për Raportin e Mjaftueshmërisë së Kapitalit (RMK) miratuar në Mars 2015 bazohet në kriteret e Bazel II dhe është në përputhje me Direktivat Europiane për Institucionet Financiare.

	Shënim	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Kapitali bazë - CET1			
Kapitali aksioner	20	5,562,518	5,562,518
Primi i aksioneve	20	1,383,880	1,383,880
Rezerva ligjore dhe rregullative	21	1,825,623	1,825,623
Fitimi i pashpërndarë		10,368,316	10,368,316
		19,140,337	**19,140,337**
Zbritjet:			
Aktive afatgjata jo materiale rregullatore		(607,690)	(695,485)
Totali i kapitalit bazë kualifikues		**18,532,647**	**18,444,852**
Aktive të ponderuara me risk:			
Në bilanc dhe jashtë bilancit		77,289,895	72,237,191
Aktive me risk për riskun operacional		8,762,143	9,038,279
Totali i aktiveve të ponderuara me risk		**86,052,038**	**81,275,470**
Raporti i kapitalit bazë ndaj aktiveve të ponderuara me risk		**21.54%**	**22.69%**

Gjatë vitit 2017, Banka e Shqipërisë nxori dhe miratoi udhëzimin "Për procesin e vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit" i cili hyri në fuqi më 31 dhjetor 2017. Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i kërkesave për bankat për hartimin dhe zbatimin e Procesit të Vlerësimit të Brendshëm të Mjaftueshmërisë së Kapitalit (ICAAP), si dhe pritshmëritë e mbikëqyrësit për strukturën dhe përmbajtjen e raportit rregullator të këtij procesi. Procesi ICAAP, i cili realizohet në mënyrë të pavarur nga banka dhe miratohet nga organet drejtuese duke përmbushur edhe kërkesat rregullatore, do të sigurojë vlerësimin e niveleve aktuale dhe të ardhshme të mjaftueshmërisë së kapitalit, bazuar në profilin dhe strategjitë e tij të rrezikut. ICAAP është përgatitur nga Banka, duke filluar nga viti 2013, në zbatim të kërkesës së Grupit të ISP dhe gjithashtu i është dorëzuar Rregullatorit në kohë në maj 2020.

8. Aktivet dhe Detyrimet Financiare

(a) Vlera e drejtë e aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare

		Vlera kontabël					Vlera e drejtë			
31 dhjetor 2020	**Shënimi**	**Letra me vlerë të investimit me kosto të amortizuar**	**Letra me vlerë të investimit me VDATP**	**Hua dhe paradhëni e bankave**	**Detyrime të tjera financiare**	**Totali i vlerës kontabël**	**Niveli 1**	**Niveli 2**	**Niveli 3**	**Totali**
Hua dhe paradhënie bankave	11	-	-	50,902,837	-	50,902,837	-	-	50,902,837	**50,902,837**
Letra me vlerë të investimit me kosto të amortizuar	12	35,083,217	-	-	-	35,083,217	3,567,125	32,112,278	-	**35,083,217**
Letra me vlerë të investimit me VDATP	12	-	36,690,487	-	-	36,690,487	3,848,556	-	-	**36,690,487**
Totali		**35,083,217**	**36,690,487**	**50,902,837**	-	**122,676,541**	**7,415,681**	**32,112,278**	**50,902,837**	**122,676,541**
Depozita nga klienti	21	-	-	-	159,507,095	159,507,095	-	-	160,237,369	**160,237,369**
Totali		-	-	-	**159,507,095**	**159,507,095**	-	-	**160,237,369**	**160,237,369**

31 dhjetor 2019	**Shënimi**	**Letra me vlerë të investimit me kosto të amortizuar**	**Letra me vlerë të investimit me VDATP**	**Hua dhe paradhëni e bankave**	**Detyrime të tjera financiare**	**Totali i vlerës kontabël**	**Niveli 1**	**Niveli 2**	**Niveli 3**	**Totali**
Hua dhe paradhënie bankave	11	-	-	29,146,303	-	29,146,303	-	-	29,146,303	**29,146,303**
Letra me vlerë të investimit me kosto të amortizuar	12	62,630,361	-	-	-	62,630,361	4,925,469	-	60,483,346	**65,408,815**
Letra me vlerë të investimit me VDATP	12	-	4,289,282	-	-	4,289,282	3,563,294	-	725,988	**4,289,282**
Totali		62,630,361	4,289,282	29,146,303	-	96,065,946	8,488,763	-	90,355,637	**98,844,400**
Depozita nga klienti	21	-	-	-	150,941,625	150,941,625	-	-	151,780,649	**151,780,649**
Totali		-	-	-	**150,941,625**	**150,941,625**	-	-	**151,780,649**	**151,780,649**

Letrat me vlerë të investimit të Qeverisë Shqiptare janë fikse dhe me bono normë të ndryshueshme. Letrat me norma të luhatshme paraqiten si rendiment mesatar i tre ankandeve të fundit të bonove të thesarit me maturim një vjeçar plus spread. Matja e vlerës së drejtë për këto letra me vlerë kryhet duke përdorur metodën e vlerësimit të tregut, duke i zbritur të gjitha flukset monetare të ardhshme që rrjedhin nga këto instrumente. Pjesa tjetër e letrave me vlerë të huaj të investimit të shprehur në valutë të huaj përfaqëson letrat me vlerë të Bankës dhe të institucioneve Financiare, vlera e drejtë e të cilëve matet sipas "rregullave të brendshme të vlerës së drejtë të ISBA". Huatë dhe paradhëniet për klientët mbahen me vlerën kontabël, e cila konsiderohet edhe si vlera e tyre e drejtë, pasi pjesa më e madhe e portofolit bazohet në normat e interesit të ndryshueshme. Vlera e drejtë e depozitave me afat nga klientët riçmohet duke përdorur vlerën aktuale neto. Normat e interesit e aplikuara janë normat e interesit të tregut të publikuara nga Banka Qendrore e Shqipërisë. Këto norma janë një vlerësim i normave të tregut. Vlera e drejtë e llogarive rrjedhëse dhe llogarive të kursimit konsiderohet e përafërt me vlerën e tyre kontabël, duke pasur parasysh që kanë maturitet afatshkurtër.

8. Aktivet dhe Detyrimet Financiare (vazhdim)

(b) Klasifikimi i aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare

Shih politikat kontabël në Shënimet 6 (g)(ii).

Në tabelën e mëposhtme paraqitet rakordimi midis zërave të pasqyrës së pozicionit financiar dhe kategorive të instrumenteve financiare.

	Shënim	Kosto e amortizuar	VDATP	Totali i vlerës kontabël
31 dhjetor 2020				
Aktive financiare				
Mjete monetare dhe të ngjashme	11	32,417,350	-	**32,417,350**
Hua dhe paradhënie bankave	12	26,736,572	-	**26,736,572**
Letra me vlerë të investimit	13	35,083,217	36,690,487	**71,773,704**
Hua dhe paradhënie klientëve	14	50,902,837	-	**50,902,837**
Totali		**145,139,976**	**36,690,487**	**181,830,463**
Detyrime financiare				
Detyrime ndaj bankave	20	2,273,426	-	**2,273,426**
Detyrime ndaj klientëve	21	159,507,095	-	**159,507,095**
Totali		**161,780,521**	-	**161,780,521**

	Shënim	Kosto e amortizuar	VDATP	Totali i vlerës kontabël
31 dhjetor 2019				
Aktive financiare				
Mjete monetare dhe të ngjashme	11	30,240,115	-	**30,240,115**
Hua dhe paradhënie bankave	12	29,146,303	-	**29,146,303**
Letra me vlerë të investimit	13	62,630,361	4,289,282	**66,919,643**
Hua dhe paradhënie klientëve	14	44,864,090	-	**44,864,090**
Totali		**166,880,869**	**4,289,282**	**171,170,151**
Detyrime financiare				
Detyrime ndaj bankave	20	2,250,043	-	**2,250,043**
Detyrime ndaj klientëve	21	150,941,625	-	**150,941,625**
Totali		**153,191,668**	-	**153,191,668**

9. Mjete monetare dhe të ngjashme

Mjetet monetare dhe të ngjashme për periudhat 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten në mënyrë të detajuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Arka	1,503,639	1,443,488
Llogari rrjedhëse në banka	14,472,573	15,454,727
Llogari të pakufizuara me bankën qendrore	873,574	7,602
Depozita me banka	15,569,556	13,334,849
Zbritja e humbjes nga zhvlerësimi	(1,992)	(551)
Totali	**32,417,350**	**30,240,115**

10. Hua dhe paradhënie bankave

Hua dhe paradhënie bankave më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Rezervë e detyrueshme në Bankën Qendrore	16,199,346	15,450,973
Depozita në banka korrespondente	10,542,703	13,699,125
Zbritja e humbjes nga zhvlerësimi	(5,477)	(3,795)
Totali	**26,736,572**	**29,146,303**

Në përputhje me kërkesat e Bankës së Shqipërisë, Banka në datën e raportimit duhet të mbajë rezervën minimale të detyrueshme në përqindjen e përcaktuar nga rregullatori (shih shënimin 7.(b).(ii)).

Këto rezerva mbahen në monedhën origjinale për detyrimet ndaj klientëve të shprehura në monedhën vendase. Për detyrimeve ndaj klientëve në monedhë të huaj, Banka është e detyruar të mbajë në monedhën origjinale.

Shuma që duhet të depozitohet llogaritet çdo muaj me vonesat. Sipas rregullores së Bankës së Shqipërisë, 70% e kësaj rezerve në Lek është e disponueshme për përdorim të përditshëm nga ana e Bankës.

Norma e interesit të rezervës së detyrueshme në Lek është 70% e normës së marrëveshjeve të riblerjes e barabartë me 1.00% për 31 dhjetor 2020 (31 dhjetor 2019: 1.00%).

Norma e interesit të rezervës së detyrueshme në EUR është e barabartë me normën bazë të interesit të Bankës Qendrore Europiane e barabartë me minus 0.50% për rezervën në EUR per 31 dhjetor 2020 (31 dhjetor 2019: minus 0.50%).

Depozitat me bankat përbëhen nga depozita me maturim fillestar me shumë se tre muaj.

11. Letra me vlerë të investimit

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Letra me vlerë të investimit të matura me VDATP - instrumente të borxhit	36,690,487	4,289,282
Letra me vlerë të investimit të matura me kosto të amortizuar- instrumente të borxhit	35,083,217	62,630,361
Totali	**71,773,704**	**66,919,643**

Letrat me vlerë të investimit të matura me VDATP më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten në mënyrë të detajuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Shoqëri emetuese	-	-
Banka emetuese	-	-
Të palistuara	-	-
Të listuara		
Qeveri emetuese	**33,108,729**	**725,988**
Republika e Shqipërisë	33,108,729	725,988
Të palistuara	-	-
Të listuara	**2,885,166**	**2,822,864**
Shtete anëtare të BE	2,885,166	2,822,864
Të listuara	**696,592**	**740,430**
Institucione të tjera financiare	696,592	740,430
Të listuara	**36,690,487**	**4,289,282**
Totali		

Letrat me vlerë të investimit të matura me koston e amortizuar më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten në mënyrë të detajuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Qeveri emetuese	**33,149,239**	**58,051,455**
Republika e Shqipërisë	31,516,092	58,051,455
Të palistuara	1,633,147	-
Të listuara	**1,933,978**	**4,578,906**
SHBA dhe shtete anëtare të BE	1,933,978	4,578,906
Të listuara	**35,083,217**	**62,630,361**
Totali		

Për periudhën deri më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 për marrëveshjet e riblerjes nuk është vendosur si kolateral asnjë letër me vlerë e qeverisë shqiptare (shih shënimin 19).

12. Hua dhe paradhënie klientëve

Hua dhe paradhënie klientëve të matura me koston e amortizuar përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Hua	41,424,672	34,780,008
Paradhënie	11,628,570	12,241,665
Komisione disbursimi të shtyra	(154,641)	(143,270)
Vlera Bruto	**52,898,601**	**46,878,403**
Zbritje nga zhvlerësimi (shih Shënimin 7.(a).(v))	(1,995,764)	(2,014,313)
Vlera totale neto	**50,902,837**	**44,864,090**

	2020			2019		
	Vlera kontabël bruto	Provizioni për humbjet e pritshme të kredisë	Vlera kontabël	Vlera kontabël bruto	Zbritje nga zhvlerësimi	Vlera kontabël
Klientët individ	24,422,811	963,457	23,459,354	23,525,741	1,103,207	22,422,534
Hua hipotekore	10,442,822	257,882	10,184,941	8,893,106	371,877	8,521,229
Hua personale	13,928,539	699,840	13,228,700	14,549,288	715,401	13,833,887
Karta krediti	30,181	4,475	25,706	73,058	14,740	58,318
Qira finanicare	21,268	1,261	20,008	10,289	1,189	9,100
Klientë Korporatë	28,475,790	1,032,307	27,443,483	23,352,662	911,106	22,441,556
Hua investimi	23,218,348	823,176	22,395,172	21,650,397	750,001	20,900,396
Kapital qarkullues	4,775,776	206,354	4,569,422	1,625,668	160,488	1,465,180
Qira financiare	481,666	2,778	478,889	76,597	617	75,980
Totali	**52,898,601**	**1,995,766**	**50,902,837**	**46,878,403**	**2,014,313**	**44,864,090**

13. Aktive afatgjata të mbajtura për shitje

Banka mban në kategorinë e aktiveve afatgjata për shitje, hua të dhëna nga VBA të cilat janë identifikuar gjatë vigjilencës së duhur të Këshillit të Ekspertëve si hua me probleme që duhet t'i trasnferohen Veneto Banca, subjekt i likuidimit të detyrueshëm administrativ, dhe huatë me rrezik të lartë të cilat tashmë janë klasifikuar si hua me probleme (në ndjekje ose të dyshimta) që duhet t'i transferohen Veneto Banca, subjekt i likuidimit të detyrueshëm administrativ, me garanci të përshtatur nga Qeveria Italiane, gjatë pagesave te radhës të komisioneve të parashikuar ne kontratë. Vlera kontabël e këtyre huave është përcaktuar në bazë të treguesve kontraktualë, të cilët përcaktuan një pagesë të barabartë me vlerën e tyre bruto pa zbritjen për zhvlerësim duke njohur vetëm 50% të vlerës të atyre që Grupi ISP do të kishte kontabilizuar në bazë të politikave të tij për zhvlerësimin e humbjeve nga huatë me çmimin që do të paguhej për ritransferimin e ekspozimit përkatës drejt Veneto Banca, subjekt i likuidimit të detyrueshëm administrativ.

14. Ndërtesa dhe Pajisje

Ndërtesa dhe pajisje më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 përbëhen si më poshtë:

	Toka dhe Ndërtesa	Pajisje informatike dhe elektrike	Mobilie dhe Vepra arti	Mjete të tjera jo elektrike	Aktive të blera por jo në përdorim	Totali
Kosto						
Gjendja më 1 Janar 2019	**1,724,985**	**1,470,556**	**301,852**	**313,245**	**221,256**	**4,031,894**
Shtesa gjatë periudhës	55,910	57,781	9,583	13,613	47,070	183,957
Pakësime	-	(403,026)	(152,626)	(87,946)	-	(643,598)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	**1,780,895**	**1,125,311**	**158,809**	**238,912**	**268,326**	**3,572,253**
Shtesa gjatë periudhës	1,890	118,989	8,713	16,968	7,199	153,759
Pakësime	-	-	-	-	-	-
Korrigjimet nga rivlerësimi	(284,426)	-	-	-	-	(284,426)
Gjendja më 31 dhjetor 2020	**1,498,359**	**1,244,300**	**167,522**	**255,880**	**275,525**	**3,441,586**
Zhvlerësimi i akumuluar						
Gjendja më 1 Janar 2019	57,270	1,250,835	255,405	277,889	-	1,841,399
Zhvlerësimi për periudhën	59,596	77,044	11,916	12,002	-	160,558
Pakësime	-	(400,187)	(151,824)	(86,776)	-	(638,787)
Shpenzime nga provizioni	-	(2,590)	-	-	-	(2,590)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	**116,866**	**925,102**	**115,497**	**203,115**	-	**1,360,580**
Zhvlerësimi për periudhën	61,422	88,398	12,565	3,650	-	166,035
Pakësime	-	-	-	-	-	-
Shpenzime nga provizioni	-	-	-	(611)	-	(611)
Gjendja më 31 dhjetor 2020	**178,288**	**1,013,500**	**128,062**	**206,154**	-	**1,526,004**
Vlera kontabël						
Më 1 janar 2019	**1,667,715**	**219,721**	**46,447**	**35,356**	**221,256**	**2,190,495**
Më 31 dhjetor 2019	**1,664,029**	**200,209**	**43,312**	**35,797**	**268,326**	**2,211,673**
Më 31 dhjetor 2020	**1,320,071**	**230,800**	**39,460**	**49,726**	**275,525**	**1,915,582**

15. Qiratë

A. Qiratë si qiramarrës (SNRF 16)

Banka merr me qira disa ambiente për degë dhe zyra. Kjo qira zakonisht ka një kohëzgjatje për një periudhë prej 10 vjet, me opsionin për të rinovuar qiranë pas kësaj date. Për disa qira, pagesa rinegociohen çdo pesë vjet për të pasqyruar vlerën e qirasë sipas tregut. Disa qira parashikojnë pagesa shtesë të qirasë që bazohen në ndryshimet e indekseve të çmimeve lokale.

Banka gjithashtu merr me qira pajisje TI në bazë të kontratave me afat nga një deri në 3 vjet. Këto qira janë qira afatshkurtra dhe/ose qira për objekte me vlerë të ulët. Banka ka vendosur të mos njohë aktivet me të drejtë përdorimi dhe detyrimet e qirasë për këto qira. Më parë, këto qira janë klasifikuar si qira operative në bazë të SNK 17. Nuk ka qira ku Banka është qiradhënëse, ndërsa informacioni mbi qiratë, në të cilat Grupi është një qiramarrës paraqitet në vijim:

*i. **Aktive me të drejtë përdorimi***

Aktivet me të drejtë përdorimi përfshijnë ambientet e marra me qira për degë dhe zyra dhe paraqiten si më poshtë:

	2020	2019
Gjendja në 1 janar	460,883	337,298
Zhvlerësimi për periudhën	(80,152)	(137,555)
Shtesat	220,428	261,140
Gjendja në 31 dhjetor	**601,159**	**460,883**

Në 31 dhjetor 2020 dhe 2019, pagesat minimale të qirasë në të ardhmen sipas qirave operative të paanulueshme paguhen si më poshtë:

Analiza e maturimit - Fluksi monetar kontraktual i paskontuar	2020	2019
Me pak se një vit	44,312	45,274
Midis një dhe pesë vjet	-	-
Më shumë se pesë vjet	-	-
Totali i detyrimeve të qirasë së paskontuar më 31 dhjetor	**44,312**	**45,274**

